

SVENSK POESI PÅ ALBANSKA - POEZIA SUEDEZE NË SHQIP
(POEZIA SHQIPE NË SUEDISHT - ALBANSK POESI PÅ SVENSKA)

I URVAL OCH ÖVERSÄTTNING AV
ZGJODHI DHE PËRKTHEU

SHQIPTAR OSEKU

KONTROLL OCH KORREKTURLÄSNING
för dikterna på svenska språket:

Ullmar Qvick
Marianne Bengtsson

Korrektorë-lektorë
për poezitë në gjuhën shqipe

Shefki Oseku
dhe
Ulmar Kvik

Dataansvarig:
Kompjuterizimi:

Frashër Oseku

Sjunde förbättrade upplagan

Botimi i shtatë, i përmirësuar

Tryckning i februari 2002

U dorëzua në shtyp në shkurt të vitit 2002

UTGIVEN AV TIDSKRIFTEN "DRITA" I TRELLEBORG – SVERIGE

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG - SUEDI

Ett stort tack till:

Arne Nilsson

och

Nisse Martinsson

båda från Trelleborg-Sverige

för all hjälp

**Shefki Oseku: chefredaktör för den albanska tidskriften
DRITA i Trelleborg - Sverige.**

Për ndihmën e pakursyer, e falenderoj përzemërsisht:

Arne Nilsonin

dhe

Nise Martinsonin,

të dytë nga Treleborgu-Suedi.

**Kryeredaktori i revistës DRITA, në Treleborg - Suedi:
Shefki Oseku.**

En presentation av svensk poesi - på albanska

Ett par ord om de översatta dikterna

Vi ger härmed till albanska läsare en möjlighet att på deras språk uppleva den svenska poesins bekymmer. Några av de författare, vars verk vi denna gång valt att publicera, tillhör de mest framstående namnen på den svenska litterära parnassen.

För att i någon mån trotsa Er nyfikenhet och samtidigt den hårda litteraturkritikens omdömen, har vi avstått från att presentera uppgifter om dikternas upphovsmän. Vi menar helt enkelt att den verkliga konsten inte kräver några ledsamma biografiska förklaringar eller en kronologisk rad av data utan tvärtom. Om hon säger ett tusen och en banaliteter till sin älskade om föremålet för sin längtan, då kan hon därmed utan avsikt helt slita sönder den ljuva sällhet som funnits i hans bild av den älskade.

Vi är övertygade om en sak: Den verkliga konsten finner på egen hand den kortaste vägen in i människohjärtat. Den behöver ingen hjälp, ingen förklaring och framför allt – liksom i varje glödande kärlek – inga sakskaäl. Den kräver bara fritt utrymme och en närhet till passionens källa.

Och med detta lämnar vi Er...

Översättaren: Shqiptar Oseku

Ju prezentojmë poezinë suedeze - në shqip

Dy fjalë për poezitë e përkthyer

Lexuesve shqiptarë po i jepet rasti që t'i përjetojnë shqetësimet e poezisë suedeze, të përkthyer në gjuhën e tyre. Disa nga autorët, krijimet e të cilëve kësaj here janë zgjedhur për botim, janë emrat më eminentë në panteonin e letrave suedeze.

Për të sfiduar sadopak kureshtjen Tuaj, por edhe mësimet e ngurta të kritikës letrare, i jemi shmangur prezentimit të të dhënave për autorët e poezive. Mendojmë, thjeshtë, se arti i njëmendtë nuk do kthjellime të mërzitshme biografike a kronologji tërkuzë datash e ditësh, po përkundrazi. Kur i flet të dashurit njëmijenjë kotërsira rreth objektit të gjakimit të vet, mundet që t'ia vjedhë me të padrejtë tërë trazimin e ëmbël të njohjes me të dashurën.

Jemi të bindur se: arti i njëmendtë e gjen vet shtegun më të shkurtër drejtë zemrës njerëzore. Ai nuk do ndihmë, nuk do kthjellime dhe, mbi të gjitha, si çdo dashuri e flaktë, nuk do arsyë – ai do vetëm hapësirë të lirë dhe afrim me burimin e pasionit.

Dhe ne ashtu Ju lamë...

Përkthyesi: Shqiptar Oseku

Këto poezi autori i ka përkthyer dhe botuar gjatë viteve 1994 – 2000, në Revistën "Drita" që ishte botim i shoqatës "BESA" në Trelleborg të Suedisë. Por, poashtu, edhe në gazetën "Besa" që botohej në Suedi.

Dessa dikter har författaren översatt och publicerat under åren 1994 –2000 i tidskriften "Drita" som utgavs av föreningen "BESA" i Trelleborg, i Sverige. Likaså i tidskriften "Besa" som även den utgavs i Sverige.

Gustaf Fröding:

I NÅGON SÅNG...

I någon nu bortglömd sång
finns en gammal regel
att om man vid spegeln står
och ser i ögats spegel
sig själv, men ingen annan
finns att se i ögonringen
då håller man av ingen.

Gustaf Frëding:

NË NJË KËNGË...

Në një këngë tash të harruar
ekziston një rregull
nëse rri para pasqyrës
dhe shikon në bebëz
veç veten, e askënd tjetër s'e vëren atje
ateherë askush ty s'të do
dhe ti s'e do askë.

Gustaf Fröding:

EN KÄRLEKSVISA

Jag köpte min kärlek för pengar,
för mig var ej annan att få,
sjung vackert I skorrande strängar,
sjung vackert om kärlek ändå.

Den drömmen, som aldrig besannats,
som dröm var den vacker att få,
för den, som ur Eden förbannats,
är Eden ett Eden ändå.

Gustaf Frëding:

KËNGË DASHURIE

Bleva dashuri me të holla,
tjetër për mua nuk kishte,
këndoi bukur o tela të holla,
dashuria e ëmbël prapë ishte.

Ajo ëndërr që kurrë s'u bë zhgjëndërr
si ëndërr ish edhe m'e mirë,
edhe për atë që në Parajsë është nëmur
Parasja është Parajsë e dëlirë.

Karin Boye:

JAG HOPPAS

Jag hoppas du inte alls har det bra.
Jag hoppas du ligger vaken som jag
och känner dig lustigt glad och rörd
och yr och ängslig och mycket störd.

Och rätt som det är så får du brått
att lägga dig rätt för att sova gott.
Jag hoppas det dröjer en liten stund...
jag hoppas du inte får en blund.

Karin Boye:

UNË SHPRESOJ

Shpresoj që nuk ndjehesh aspak mirë.
Shpresoj që si unë ke mbetur shtrirë
e ndjehesh e prekur dhe e llastuar,
e stepur e trembur dhe shumë e hutuar.

Dhe befas të duket sikur të flehet,
trupi dhe mendja në gjumë ndoshta prehet.
Shpresoj se gjumi do të vonoj një çikë...
shpresoj se s'do t'mund t'i mbyllësh sytë.

Elsa Grave:

MÅSTE VI GÅ LÖST

Måste vi gå löst
på varandra i tusen år
för att kunna älska
en enda dag?

Är en enda dag av kärlek
värd dessa århundraden
av sorg?

Är alla århundraden
av sorg
en moder
av en enda dag av kärlek?

Måste vi fortsätta
att återigen på nytt
sörja vår moder i tusen år?

Elsa Grave:

A DUHET T'I MËSHOJMË NJËRI TJETRIT

A duhet t'i mëshojmë
njëri-tjetrit njëmijë vjet
që të duhemi
vetëm një ditë?

Një ditë e vetme e dashurisë
ia vлека, vallë, këta qindvjetësh
të pikëllimit?

Mos qenkan tërë shekujt
e pikëllimit
nënë
e një dite të vetme të dashurisë?

Vallë, u dashka të vazhdojmë kësisoj
që përsëri edhe një herë
ta qajmë nënën tonë për njëmijë vjet?

.

August Strindberg:

UR LANDSFLYKT

Statt upp och förkunna!
För släkt och ovänner,
för en avundsjuk värld
att mina ögon skådat din härlighet,
choucroute-och jambondoftande,
spårvagnstutande,
skyltbehängda
smutsiga
oktober Paris!
Jag har lagt sista handen
vid min vårdade uppfostran,
ty jag har beskådat dina oljefärgstavor,
Louvre!
Och jag har låtsats falla baklänges
inför Venus Milo!
Min ära är räddad,
ty jag har haft tråkigt
på Théâtre Français,
jag kan räcka min behandskade hand
åt det bildade samhället,
ty jag har sett madame Judic
som sköna Helena!
Min omtvistade dygd
är numera odisputabel
sedan jag dansat på Bal Bullier
och sett studentmätressernas strumpeband
blandas med sidenslips
och talmikedjor.

Mitt lärda anseende är stadgat
sedan jag en hel halvtimme
frågat efter ett obefintligt
Gothans Missale
i Bibliothèque S:te Geneviève,
mitt republikanska nit
har känt sig livat
vid åsynen av de brända Tuilerierna,
men mitt förbannade gamla hjärta
är lika obildat,
lika olärt,
lika oförbätterligt eländigt
som förut.
Du gamla strunthjärta!
Och jag har ändock hängt in dig
till rökning i S:t Germain L'Auxerrois
och jag har vädrat dig i Marly-le-Roi
jag har givit dig gott vin och dåliga kvinnor i Montmartre,
jag har promenerat dig i Champs-Élysées
och du har dinerat försvarligt i Palais-Royal!
Vad vill du då mer,
du otidsenliga,
gammalmodiga
nutidssträvande hjärt-elände!
Vad vill du då mer?
Ha! du falska hjärta,
du längtar
och du kämpar.
Du längtar till det fula landet
med de vackra ögonen,
du längtar efter det dagliga ovettet
och de lördagliga dumheterna,

du trånar efter det fjärran brännvinslandet,
det stolta öl-och-brännvinslandet
och dess europeiskt ryktbara
kakelugnar.

Du suckar efter förlossning
från fuchsin-förfalskat rödvin,
skämd blomkål!
och brända kastanjer.

Bekänn, hjärta!

Du leds vid den konservativa republiken
och längar efter Karl den tolfte, hjärta!

Jag hör, hjärta,
hur dina klaffar smälla
som det smäller i dörrar,
och jag hör, hjärta,
hur det gnisslar och bultar
som det gnisslas i byråådor
och bultas i packlårar
när man skall ut och resa.

Bekänn, hjärta:

Du har redan packat
och kanske också köpt biljett!
Jag vet att du har gjort det, hjärta!
Ser du! Ser du!

August Strindberg:

NGA MËRGIMI

Po i bëj me dije!
Të dashurit dhe armiqtë
tërë botën xheloze
se sytë e mi kanë parë harlisjen tënde
aromat tua dehëse,
ushtimën e tramvajeve tua,
reklammat tua të varura
o i ndyri
Paris i tetorit!
I kam dhënë dorën e fundit
edukatës sime të kultivuar,
kur pashë pikturat tua në vaj,
o Luver!
Dhe jam bërë sikur alivanozem
para teje, Venerë e Milosit!
Kam dalur me nder,
se kam ndjerë monotoni
në mes të Teatrit Francez,
tash dorën time
me dorëza të bardha mund t'ia zgjas
tërë qarqeve të arsimuara,
se kam parë Madam Judikën
e Helenën e bukur!
Virtytet e mia të dyshimta
tash janë të padiskutueshme
pasi kam vallëzuar në Bal Bulier
e i kam parë getet e dashnoreve studentore
si përziheshin me kravata të mëndafshhta
e vemëz talmimi.

Fama ime si njeri i ditur tash ka rrënjë të thella
pasi para nja një gjysmë ore
kërkova e s'mund ta gjeja
Misalin e Gothas
në Bibliotekën e San Zhenevievës,
zelli im republikan
gufoi
sapo më panë sytë Tuilerinën e djegur
po zemra ime e nëmur
është njësoj e pagdhendur,
e paarsimuar,
po ai mjerim i papërmirësueshëm
si përherë më parë.
Ti zemër e marrë!
E unë prapë të mora me vete
në vardisjet e mia nëpër San Zherman L'Oksero
e të ajrosa në Marly-le-Rua
të dhashë verë e gra të këqia në
Montmarter,
shetita me ty nëpër Shanzelize
e të ftova për darkë në Palas Rojal!
Çfarë do më tepër nga unë,
ti që je kaq moderne,
kaq jetike,
ti zemërmjerimi im bashkëkohor!
Çfarë do më tepër?
Bah! Ti zemër gënjeshtare,
ti ke mall
e lufton.
Ti ke mall për atë vendin e shëmtuar
me sy aq të bukur
ti ke mall për marrëzitë e përditshme
e për marritë e të shtunave,

ti gjakon për vendin e largët të rakisë së pjekur,
vandin krenar të birrës e të rakisë së fortë
e për stufat tua me pllaka qeramike
të njohura në Evropë.

Ti ofshanë e lyp shpëtim
nga verërat e kuqe falso,
nga kryelakrat e kalbura
dhe nga gështenjat e djegura.

Prano, zemër!

Ti je mërziur nga republika konzervative
dhe ke mall për Karlin e Dymbëdhjetë, zemër!

Unë ndjej, zemër,
se si rrahin barkushet tua
si ushtima dyersh të përplasura,
i ndjej, o zemër,
gërvishtjet e kërcitjet tua,
si gërvishtjet kur zbrazen syzet
e kërcitjet sikur që mbyllen valixhet
para një udhëtimi.

Prano, zemër:

Ti tashmë i ke mbledhur sendet tua
e mbase edhe ke prerë biletën!
E di që ti atë punë e ke bërë, zemër!
Të zyra! Të zura!

Edith Södergran:

UPPTÄCKT

Din kärlek förmörkar min stjärna
månen går upp i mitt liv.
Min hand är ej hemma i din.
Din hand är lusta
min hand är längtan.

Edit Södergran:

ZBULIMI

Dashuria jote ma ka errësuar yllin
hëna është ngritur mbi jetën time.
Dora ime s'qenka thënë për tënden.
Dora jote është pasion
dora ime është mall.

Edith Södergran:

DU SÖKTE EN BLOMMA

Du sökte en blomma
och fann en frukt.
Du sökte en källa
och fann ett hav.
Du sökte en kvinna
och fann en själ.
Du är besviken.

Edit Södergran:

LYPE NJË LULE

Ti lype një lule
e gjete një frut.
Ti lype një gurrë
e gjete një det.
Ti lype një grua
e gjete një shpirt.
Ti je i zhgënjyer.

Verner von Heidenstam:

JAG LÄNGTAR HEM SEN ÅTTA
LÅNGA ÅR

Jag längtar hem sen åtta långa år.
I själva sömnen har jag längtan känt.
Jag längtar hem. Jag längtar var jag går
- men ej till människor! Jag längtar marken,
jag längtar stenarna där barn jag lekt.

Verner von Heidenstam:

**KA TETË VITE TË GJATA
QË KAM MALL SHTËPINË**

Ka tetë vite të gjata që e kam mall shtëpinë.
Edhe në gjumë mallin e kam ndjerë.
Kam mall. Ngado shkoj kam mallëngjim
- po, jo për njerëzit! Për tokën e mjerë,
për gurët ku si fëmijë luaja ngaherë.

Göran Palm:

HAVET

Jag står framför havet.

Där är det.

Där är havet.

Jag tittar på det.

Havet. Jaha.

Det är som på Louvren.

Jëran Palm:

DETI

Rri përpara detit.
Ja, ku është.
Ky është deti.
E shikoj
Deti. Ë-hë.
Qenka si në Luvër.

Erik Blomberg:

GRAVSKRIFT

Här vilar
en svensk arbetare.
Stupar i fredstid.
Vapenlös, värnlös.
Arkebuserad
av okända kulor.

Brottet var hunger.

Glöm honom aldrig!

Erik Blomberg:

EPITAF

Këtu pushon
një punëtor suedez.
Ra në kohë paqeje.
I paarmatosur, i pambrojtur.
I pushkatuar
nga plumba të panjohur.

Krimi i tij qe uria.

Mos e harro kurrë!

Erik Blomberg:

I DINA HÄNDERS MJUKA FÅGELBO

I dina ögons klara morgon ljus
mitt hjärta vaknar-allt är ljus.

I dina läppars höga kärlekssång
min glädje brusar-allt är sång.

I dina händers mjuka fågelbo
min oro somnar-allt är ro.

Erik Blomberg:

DUART TUAJA-FOLE ZOGJËSH

Në dritën e kthjelltë mëngjesore të syve tu
zemra ime zgjohet-çdo gjë ndrinë.

Në buzë tua, këngët madhështore të dashurisë
Gëzimi im gurgullon-çdo gjë është këngë.

Në duart tua, fole të ngrohta zogjësh
Shqetësimin tim e zë gjumi-çdo gjë prehet.

Pär Lagerkvist:

I SJÄLENS GRÄNDER

I själens gränder
där lyktorna står långt ifrån varandra
så att det är svårt att kunna hitta husnumren.
Där har jag sökt länge.
Förgäves.

Kanske jag sökte efter för höga nummer,
som inte finns.
Kanske står jag vid grändens slut
och ser med torra ögon ut i en natt
som inte längre skrämmer mig.

Per Lagerkvist:

NË RRUGËZAT E SHPIRTIT

Në rrugëzat e shpirtit
ku dritat janë larg prej njëra-tjetrës
e është vështirë të gjesh numrat e portave.
Atje të kam kërkuar që moti
Kot.

Mbase të kërkoja te numra tepër të mëdhenj,
çfarë nuk ekzistojnë.
Mbase tash kam ardhur te fundi i rrugës
dhe sytë e tharë i kredh në këtë natë
që s'më tremb më.

Elmer Diktonius:

BARNET I TRÄDGÅRDEN

Barnet i trädgården
är ett underligt ting:
ett litet litet djur
en liten liten blomma.
Det myser som en katt åt nejlikorna
och skrubbar sitt huvud
mot solrosens jättestängel.
Tänker kanske: sol är gott
grönt är gräsfärg.
Vet kanske: jag växer!

Elmer Diktonius:

FËMIJA NË KOPSHT

Fëmija në kopsht
është diçka e çuditshme:
një kafshëz e vogël e vogël
dhe një lulëz e vogël e vogël.
Karafilët i shpupurish si mace
dhe kruan kokë e vet
në kërcellin e gjatë të lulediellit.
Mbase mendon: dielli qenka i mirë
blerimi qenka ngjyra e barit.
Mbase e di: unë po rritem!

Göran Sonnevi:

OM KRIGET I VIETNAM

Bakom TV'n ändrades ljuset
utanför fönstret. Mörkret byttes
mot grått och träden framträdde
svarta i det klara gråa ljuset
från nysnön. På morgonen
var allt igensnöat. Jag går nu
ut och sopar efter stormen.
Jag hör i radio att USA
gett ut en vitbok
om kriget i VIETNAM
i vilken Nordvietnam anklagas
för aggression. I går kväll
på TV
såg vi en filminspelning från
Viet Congs sida, fick höra
helikoptermaskinernas
dova fladdrande,
från marken, från de beskjutnas
sida. I en annan film
för ett par veckor sedan
intervjuades de amerikanska
helikopterförarna av CBS. En av dem
beskrev sin utlösning
när han äntligen fick skott på
en "VC": han slungades
tre meter fram
av raketerna. Det blir
säkert mer snö i dag,
säger min granne, svartklädd

på väg till sitt arbete. Han
balsamerar döda och är nattvårdare på
mentalsjukhus. Trakten jag bor i - Lund
med omnejd-blir en allt vitare
bok, solen kommer och lyser
brännande kall över de vidsträckta sidorna.
De döda är siffror, som vilar, vilar
som kristaller, i vinden över fälten. Hittills
beräknas 2 miljoner ha dött i VIETNAM.
Här dör knappast någon
av annat än personliga skäl. Den svenska
ekonomin dödar numera
inte många, i varje fall
inte här i landet. Ingen för
krig i vårt land för att skydda
sina egen intressen. Ingen
bränner oss med napalm
för en feodal frihets skull.
På 14-och 1500-talet fanns ingen napalm.
Solen stiger här mot middag.
Det är snart mars 1965.

Varje dag
dödas fler och fler i USA:s smutsiga krig
Snöflingorna på bilden av
president Johnson
vid tiden för de sista bombningarna
i Nordvietnam - han steg
ut eller in i en bil - faller
allt tätare över de vita sidorna.
Fler döda, fler rättfärdiganden,
tills allt snöar igen
i den natt som slutgiltigt
ändrar sitt ljus utanför fönstren.

Jëran Sonevi:

MBI LUFTËN NË VIETNAM

Pas TV-së u shndërrua drita
prapa dritareve. Terri u kthye
në të hirtë dhe drunjtë dukeshin
të zi në kthjelltësinë e blertë të ditës
mbi borën e parë. Në mëngjes
gjithçka ish mbuluar me dëborë. Tashti unë
dal e pastroj pas stuhisë.
Dëgjoj në radio se SHBA
ka botuar një libër të bardhë
mbi luftën në VIETNAM *
në të cilin Vietnami Verior paditet
për agresion. Dje mbrëmë
në TV
e pamë një inçizim filmik
të Viet Kongut, na ra të dëgjojmë
ushtimën e shurdhër
të helikopterëve,
nga toka,
nga ana e të gjuajturve.
Në një tjetër film para nja dy javësh
u intervistuan amerikanët,
pilotët e helikopterëve, nga CBS. Një nga ata
përshkroi orgazmin e vet
kur, më në fund, ia doli të qëllonte,
një "VC" : u plandos *
tre metra tutje
nga raketat. Do të bjerë
sigurisht prapë dëborë sot,
thotë fqiu im në të zeza

duke u kthyer nga puna. Ai
balsamos të vdekur dhe është kujdestar i natës
në një spital psikiatrik. Treva ku banoj - Lundi
me rrethinë - bëhet një libër
gjithnjë e më i bardhë,
dielli vie e ndriçon
me ftohtësi djegëse mbi faqet hapekrah.
Të vdekurit janë shifra, që pushojnë, vërtiten
si kristale, në erën mbi fusha. Gjer tani
dy milionë veta llogaritet të jenë vrarë në VIETNAM.
Këtëj gati askush më nuk vdes
pos nga shkaqe personale. Ekonomia
suedeze tash nuk vret më shumë veta,
të paktën jo këtu, brenda vendit. Askush
nuk zhvillon luftë në vendin tonë
për t'i mbrojtur interesat e veta. Askush
nuk na djegë me napalm
për hir të një lirie feudale.
Në shekujt XV e XVI nuk kishte napalm.
Dielli ngrihet drejt mesditës.
Së shpejti do të jetë mars 1965.

Secilën ditë
vriten gjithnjë e më shumë në luftën e ndyrë të SHBA-ve.
Fjollat e borës në fotografinë e
presidentit Xhanson
me rastin e bombardimeve të fundit
në Vietnamin Verior - ai ish kërrusur
duke dalur a duke hyrë në një auto - bien
gjithnjë e më dendur mbi faqet e bardha.
Edhe më të vdekur, edhe më justifikime,
gjersa gjithçka të jetë mbuluar me dëborë
në atë natë që përfundimisht
po e shndërron dritën prapa dritareve.

* Poeti shkruan demonstrativisht VIETNAM me shkronja të mëdha, për t'u pozicionuar publikisht kundër copëtimit të vendit në pjesën veriore e në pjesën jugore.

* VC = Viet Cong, emri zyrtar i ish-Vietnamin Verior dhe njëherit nofkë amerikane për luftarët vietnamezë.

Göran Sonnevi:

DET FINNS...

Det finns
längst inne i mig
en punkt av stillhet
som ingen kan förstöra.
Kunde jag bara
ta en flik av den i min hand
och ge den åt någon,
åt henne som jag älskar.

Jëran Sonevi:

EKZISTON...

Ekziston
diku thellë në veten time
një pikë e prehjes
që asnjëri nuk e prish dot.
Sikur të arrija
ta merrja një copëz në dorë
për t'ia dhënë dikujt,
asaj që e dua.

Johannes Edfelt:

VESTROGOTICA

Vind från hedenhös, vind genom seklerna, blås,
kamma gräset i Eddås, Våmb och Horn,
där de multnar: ryttare, bönder. Lång
var deras möda, sträv deras dagsverkes kväll.
Skönast slutgiltigheten: jord och vind.

Juhanes Edfelt:

VESTROGOTIKA *

Erë e lashtë, erë shekujsh, fryj,
krehe barin mbi Edosa, Vomb e Hurn,
ku kalben: kalorës, bujq. Zgjatën shumë
vuajtjet e tyre, e thatë kafshata e darkës.
Më i ëmbël fundi: tokë e erë.

* Vestrogotët, sipas nacionalromantikës suedeze, janë vikingët nga Gotalandi Perëndimor, njëra nga trevat e Suedisë.

Bertil Malmberg:

RADIOLYSSNARE

När han hörde rapporterna
om Auschwitz
skrällande genom Hades
då darrade
Heliogabalus, den unge Syriern,
lyssnade jämte sin moder.

Mer! stönade han
och stampade med foten:
den kraftlösa skuggfoten...

Bertil Malmberg:

DËGJUESI I RADIOS

Kur i dëgjoji raportet
për Aushvicin
duke uturuar nëpër Had
atëherë u drodh
Heliogabali, siriani i ri,
duke dëgjuar në prehërin e së ëmës.

Edhe më! ofshau ai
dhe rrahu më këmbë:
me këmbëhijen e pafuqishme... *

* Këmbët e cjamin që djalli, sipas
besimit popullor, orvatet përherë t'i fshehtë.

Artur Lundkvist:

KÄRLEK TILL TRÄ

Kärlek till trä
kräver det skarpaste stål,
säger snickaren.

Artur Lundkvist:

DASHURIA PËR DRURIN

Dashuria për drurin
kërkon çelikut më të mprehtë,
thotë zdrukthëtari.

Bosse Parnevik:

ALLA ÄR VI MÄNNISKOR

En kommer hit för att fly från nöden
En kommer hit för att undgå döden
En kommer hit, av terror tvungen
En kommer hit för att gifta sig med kungen
Dom är tyskar, iranier, greker och turkar
Mest är dom snälla, andra är skurkar
En del är ärliga, andra skumma
En del är genier, andra är dumma
Mest är dom fredliga, andra vill slåss
Med andra ord: DOM ÄR SOM OSS
Med fel och brister, tuffa och mjuka
Fast inte lika avundsjuka...
Vissa är färgade, andra är arier
Som köper sin bruna färg i solarier
Vissa är svarta, andra gula
Vissa är vackra, andra är fula

Men fast dom ibland har andra färger
Är de precis som vi i Sverige
Och när dom vill jobba här är tacket:
"Ni får inte jobba än för facket"
En del är båtfolk från Vietnam
Som inte kan sjunga "We shall overcome"
Och inte kan "Rulla di rulla" som vi
Och dom blir sällan så fulla som vi
En del är mer judar än vi
En del har andra gudar än vi
En del söker lugnet istället för bråket
Det enda vi svenskar kan bättre är språket
Det sägs att vi stammar från Adam och Eva
Som inte var svenskar - men ja må dom leva!

Bose Parnevik:

TË GJITHË JEMI NJERËZ

Një vjen për t'i ikë mjerimit
Tjetri ikë prej vdekjes e mundimit
Dikë e ndjek terrori, të shkretin,
Dikush vjen e martohet me mbretin *
Janë grekër e turq, gjermanë, iranianë
Shumica të urtë, disa horra janë
Ca janë të sjellshëm, ca me sherr e kanë
Një pjesë janë gjeni, një pjesë të shastisur
Shumica paqësor, po ka edhe të krisur
Me fjalë të tjera: ATA SI NE JANË
Të fortë, të butë, një cen të gjithë e kanë
Veç xhelozinë si tonën s'e kanë... *
Ca janë të errët, ca arianë
Që rreziten përditë për t'u nxirë taman
Një është i verdhë tjetri zezak,
Një i bukur, tjetri shëmtak

Kanë ngjyra gjithfare, por s'dua ta di:
Të gjithë janë njësoj, këtu në Suedi.
Kur duan punë, të fitojnë paga
U themi: "nuk bënë, s'lejon sindikata"!
Ca vinë nga lundrat e Vietnamit
E s'dinë të këndojnë "We shall overcome" *
S'e dinë këngën "Rulla di rulla" si ne *
E nuk dehen shpesh si dehemi ne
Ca janë më çifutët se sa jemi ne
Disa kanë zotëra të tjerë nga ne
Qetësinë e duan disa-jo telashzet,
Veç gjuhën n'e dishim më mirë ne, suedezët
Gjithë bota, thonë, nga Adami e Eva burojnë,
Që s'ishin suedezë - po përjetë le të rrojnë!

* Fjala është për mbretëreshën e Suedisë, e cila vetë është e huaj, nga Brazili dhe me origjinë është gjermane.

* Suedezët thuhet se e kanë smirë suksesin e njëri tjetrit.

* We shall overcome-këngë e Bitëllsve. Këtë këngë Lëvizja për të drejtat qytetare në SHBA e ktheu protestë kundër racizmit dhe diskriminimit racial.

* Rulla di rulla-këngë popullore suedeze.

Gunnar Ekelöf:

OKTOBER

(tanke på Karin Boye)

Jag är en fullmogen frukt
som fruktar att falla
bli fallfrukt.
O knoppar!
O droppar!
O sol, plocka mig,
rädda mig från marken!

Gunar Ekelëf:

TETORI

(kushtuar Karin Boyes)

Jam një frut plotësisht i pjekur
që frikësohet të bie në tokë
të bëhet frut i rënë.

O burbuqe!

O pika që rrjedhni!

O diell, më mblidhni,
e më ruani nga toka!

Gunnar Ekelöf:

TITANIC

Alltid är människan
mitt i världen:
Ser hon omkring sig
är trollkretsen sluten.
Alltid är människan
mitt under himlen:
Ser hon uppåt
följer henne zenith.

Hur än aftonrodnaden bleknar
bortom det svallande havet,
hur världen än svartnar,
hur du än spanar i natten,
stängd i det ovissa mörkrets bur,
mot nadir sjunkande:
Alltid förblir du
uppåt fri.

Gunar Ekelëf:

TITANIK

Njeriu është përherë
në mes të botës:
ngado të shikoj përreth
qarku është i mbyllur.
Njeriu është përherë
mu përfundi qiellit:
ngado të shikojë përjetë
e ndjek zeniti.

Si do të zbehet i purpurti muzg
matanë detit të shkrumuar,
sado të nxihet kjo botë,
sado ti prore ta vështrosh natën
e ndyrë në kafazin e paditur të territ,
që fundoset drejt Kaut të Zi:
Prore do të mbetesh
i lirë përpjetë.

Gunnar Ekelöf:

STADSPLAN

Utan att möta ett hinder
kröker sig gatan åt höger.
Jag vandrar i meningslösheten
bland nya förfallna byggen.

Den fullhängda bussen är ödslig
och tvätten bland tallarna övergiven.
Om här bara inte fanns människor!
Det blir så tomt därför att här bor människor.

Gunar Ekelëf:

PLANI I QYTETIT

Pa pasur asnjë pengesë
kthehet rruga në të djathtë.
Unë shetis në mënyrë të pakuptimtë
mes ndërtimeve të reja, të rrënuara.

Autobusi i mbushur plot është i shkretë
dhe rrobat e lara mes bredhave janë braktisur.
Oh! Si të mos kishte njeri në këtë vend!
Është kaq zbrastësi - sepse këtu banojnë njerëz.

Gunnar Ekelöf:

SOM I BALLADEN

O grunda Djup
O nära himmel
Jag har ju inte mer än 10 mil på mig
till Evigheten
medan Helvetet skäller under fötterna
och jag går här själv
på den Skeppsskorpa jag gnager
andas den luft jag måste leva av
till dess det blir ett blått hål
upptill eller nertill

Jag tror inte på någondera Stället
Jag vet att jag har vänner
som i balladen
både här och där

Gunar Ekelëf:

SI NË BALLADË

O Thellësi të cekta
O i afërti qiell
Unë nuk jam më larg se njëqind kilometra
deri te Përjetësia
derisa Ferri leh nën thembra
dhe unë eci këtu vet
duke përtypur bukën pogaçe
frymoj se duhet të jetojë
derisa të hapet një vrimë e kaltër
lartë ose tatpjetë

Unë nuk besoj në asnjë Matanë
e di se kam miq
si në baladë
këtu, po edhe atje

Gunnar Ekelöf:

NATTVANDRAREN

Här är Stora Sibirien
och där är Lilla Sibirien.
Här är gatans jämna nummer
och där är dess udda:

Ett plus två hus är ett hus.
Tre gånger fyra hus är ett och samma hus.
Ja, fem upphöjt till sex hus
är ändå bara ett enda, likadant hus!

O sene nattvandrare!
Du som aldrig förstått
att skaffa dig nummer och namn!
Var i vida världen
äger du ett hem?

Gunar Ekelëf:

SHETITËSI I NATËS

Këtu është Sibiri i Madh
e atje është Sibiri i Vogël.
Këtu janë numrat e rrugës çift
atje janë ata tek:

Një plus dy shtëpi është një shtëpi.
Tri herë katër shtëpi është po ajo shtëpi.
Po, pesë shtëpi në fuqinë e gjashtë
janë vetëm një shtëpi e njëjtë!

O shetitës i vonë i natës!
Ti që kurrë s'ke ditur
t'i krijosh vetit numër e emër!
Në ç'vend, në këtë botë të pafund
e ke ti shtëpinë?

Gunnar Ekelöf:

MAN SÄGER...

Man säger ingenting nytt då man säger:
Ett konstverk är oberoende av sin konstnär!
Det gör sig oberoende
och lever sitt eget liv
i sin egen fortvaro.

Detta visste de gamle, de anonyma
som aldrig signerade,
eller endast satte sitt namn på den ikon
de behöll för sig själva.

Gunar Ekelëf:

THUHET

S'është thënë asgjë e re - kur thuhet:
Një vepër artistike është e pavarur nga artisti!
Ajo bëhet e pavarur
dhe jeton jetën e vet
duke gjëlluar.

Këtë e dinin ata të parët, ata anonimët
që kurrë nuk firmosnin,
ose që emrin e venin veç në atë ikonë
të cilën e mbanin për vete.

Gunnar Ekelöf:

RESENÄR

Rocken hänger på stolen,
i plånboken biljetten.
Väskan står färdigpackad,
väckarklockan är ställd.

När kan man sova så tryggt
som när man är färdig här eller där
och nya förhållanden väntar!

Månskenet faller blått genom fönstret:
Se hur det skiftar sitt ansikte,
detta rum som man lämnar för alltid,
nyss så välbekant, redan främmande!

Tänkte man jämt på döden
sov man alltid så tryggt.

Gunar Ekelëf:

UDHËTARI

Pardesynë e ke varur në karrige,
në kuletë bileta.

Valixhja pret e palosur,
ora e kurdisur për zgjim.

Kur mund të flehet më qetë
se sa kur ke mbaruar punë, këtu apo atje,
e je gati për takime të reja!

Drita e kaltër e hënës kredhet nëpër dritare:
Shih si ndërron fytyrën e vet,
kjo dhomë që e lë përgjithmonë,
që ish aq e njohur, e tashmë e huaj!

Po të mendonim përherë për vdekjen
gjithmonë do të flenim të qetë.

Gunnar Ekelöf:

DE DÖDA

De levande dör länge.
De dör genom åren,
förändras av livet,
förvandlas av döden.
Först flyr dem hälsan,
sen flyr dem jaget,
bestämmanderätten
Men när blir de döda?

De döda dör längre.
Så sakta förvandlas de
att ingen kan veta
när allt av liv försvunnit.
De lever inom oss
som var de ännu varma.
Vi lever i dem
som om vi kallnade sakta.

De döda är levande.
Så sakta lever de,
förbrinnande, förmultnande
till sista knotan.
De döda är levande.
De lever omkring oss
som väntade de tåliga
tills alla samlats.

Gunar Ekelëf:

TË VDEKURIT

Të gjallët vdesin gjatë.
Ata vdesin viteve,
i ndërron jeta,
i ndërron vdekja.
Se pari u liget shëndeti,
pastaj u ik uni,
e drejta e vendosjes
Por kur bëhen të vdekur?

Të vdekurit vdesin gjatë.
Dalë-ngadalë ata ndërrojnë formë
që askush të mos e dijë
se gjithë jeta i ka lënë.
Ata gjëlljnë midis nesh
sikur të ishin ende të nxehtë.
Ne jetojmë me ta
sikur të ishim duke u ftohur.

Edhe të vdekurit gjëlljnë.
Dalë-ngadalë frymojnë,
duke e djegur, duke e kalbur
edhe ashtin e fundit.
Të vdekurit gjëlljnë
Ata vejevijnë rreth nesh
sikur janë duke pritur
që të mblidhen të gjithë së bashku.

Maria Wine:

MÅLTID

Får jag bjuda på en måltid?

Först

gryningsblå soppa kokt på violer

Sen

upptinade fotspår efter ett rådjur

och en sallad gjord på snödroppshuvuden

Till dessert

en månskiva gul som honung

och len i smaken som en melon

Vinet?

Naturligtvis

samma vin till alla rätter:

en nyss frigiven källas

vattenglädje.

Marie Vine:

SHUJTA

A mund të vini për drekë?

Se pari

supë nga kaltrina e agut gatuar me vjollca

Pastaj

fërkemë të shkrirë të një sute

e sallatë me gonxhet e lulebores

Për desert

një flegër hëne të verdhë si mjalti

e me shije të këndshme si pjepri

Verë?

Natyrisht

e njejtë verë për të gjitha shujtat:

ujmirë

nga një gurrë shpërthyer pak më parë.

Maria Wine:

VID MORGONENS RODNAD

Vid morgonens rodnad
stiger havsjungfrun upp ur nattens hav,
skakande vattnets tyngd från sin kropp,
tills endast några droppar lyser som fjäll
på hennes nakenhet.
Hon sätter sig på strandens svartblanka sten
med ansiktet mot den uppgående solen,
det havsgröna håret faller tungt över de
nakna axlarna,
vinden torkar det med sina luftiga händer
och med en sista levande rörelse
fäster hon det underbara gröna i en knut.

Där sitter hon orörlig
som sammanväxt med stenen
och blickar ut över sin värld;
aldrig har någon dag skådat en så vacker kvinna,
aldrig har någon man ägt en så åtråvärd kvinna.

Men i kvällens mjuka mörker
löser hon åter sitt långa hår
och sjunker tyst i havet.

Marie Vine:

NË MËNGJESIN E PURPURTË

Në mëngjesin e purpurtë
del shtojzovallja nga deti i natës,
peshen e ujit e shkund nga trupi i vet,
gjersa veç ca pika të mbetën si luspa
në trupin e saj lakuriq.
Ajo ulet në gurin shkëlqimzi të plazhit
me fytyrë kah lindja e diellit,
flokna e saj e blerët si deti
i derdhet supeve të lakuriquara,
era ia thanë me duart e veta të ajrosura
dhe me një lëvizje, si drithmë e fundit e jetës,
blerimin fanitës e përdredhë mbi qafë.

Atje diku ajo rri ulur
si t'ishte rritur bashkë me gurin
dhe hedh sytë mbi botën e vet;
kurrë nuk është parë një grua më e bukur,
kurrë nuk ka patur një grua më tërheqëse.

E në terrin e shkriptë të muzgut
ajo i shkreh flokët e vet të gjatë
dhe heshturazi zhytet në det.

Maria Wine:

UTAN MIG

Mitt liv

du går utan mig

du mäter din tid inom mig och utan mig

du rinner bort som tårar på min fönsterruta

du böjer min rygg under en osynlig piska.

Din erbjudna stege av löst knutna knutar

kan endast bära en bevingad fågel

som inte är jag.

Och framför och bakom mig

växer din djungel så tät

att jag inte kan se min egen stig

eller höra mina egna steg.

Hur ska jag någonsin få veta

om jag rör mig framåt eller bakåt.

Mitt liv du går din väg genom mig

utan mig.

Marie Vine:

PA MUA

Jeta ime
ti ec pa mua
e matë kohën tënde në mua e pa mua
rrjedhë tutje si lotët në qelqet e dritares
shpinen ma kërrus me fshikull të padukshme.
Ura që m'ofron prej litarit thurrur shlrë
veç një zog me flatra mund ta mbajë
unë nuk jam e tillë.
Dhe para e prapa meje
rritet dendur xhungla jote
sa nuk shoh më shtegun tim
as dëgjoj hapat e mi.
Si ta kuptoj ndonjëherë
nëse lëvizi para apo prapa
Jeta ime ti ec rrugës sate nepër mua
Pa mua.

Maria Wine:

FRID

Jag sover utan att sova
jag bor i din ensamhet
med min ensamhet
ett är sant
att två tillsammans
är och förbli en-plus-en
men också att detta plus
aldrig kan bli ett minus.

Jag väntar på svar
ljus eller mörker
gråten är nära
den håller sig alltid beredd
glädjen van vid besvikelse
vakar längre borta
vi får se
vem som kommer först.

Det gör ont
att visa dig att det gör ont i mig
jag agar mitt behov av klagan
jag tänker i rött
fast jag går i svart.

Jag syr tofflor av mossa åt oss båda
och skuggan av en utebliven smekning
tvättar jag bort
med minnen av andra smekningar.

Jag seglar på en sömnig flod
min kropp är min båt
små vågor vaggar mig
himlen är ett porträtt av dig
jag vilar med korslagda armar
jag vilar i frid.

Marie Vine:

QETËSIA

Unë flej pa fjetur
banoj në vetminë tënde
me vetminë time
një gjë është e vërtetë
se dy vetë së bashku
janë dhe do të mbeten një-plus-një
por se edhe ai plus
kurrë s'mund të bëhet minus.

Pres përgjigje
dritë apo terr
vaji është pranë
ai është përherë gati
gëzimi është mësuar me zhgënjime
bën roje diku larg
do ta shohim
kush arrin i pari.

Po më dhemb
të të tregoj se kam dhembje
ankesës sime i bie shpullë
të kuqen e mendoj
ndonëse shkoj veshur në të zeza.

Qepi pantofla nga myshku për ne dy
e hijen e një ledhatimi të pandjerë
e shpërlaj
me kujtime përkëdheljes tjera.

Lundroj në një lum të përgjumur
trupi im është lundra ime
valë të vogla më përkundin
qielli është portreti yt
pushoj duarkryq
pushoj në qetësi.

Maria Wine:

VÅRSORG

Det är svårast när det skymmer om våren
Obarmhärtigt visar rymden sin nakna intighet
Allt blir så tveksamt:
minnens smekningar, skuggornas svepningar
Allt blir så fjärran:
även den älskades närvaro.
Vårt lånade liv väcks till insikt
om återlämnandets timme:
vårt tack uteblir av sorg.
Det är svårast när det skymmer om våren.

Marie Vine:

PIKËLLIM PRANVERE

Më së rëndi është kur erret në pranverë
Gjithësia e tregon pa mëshirë afrinë e vet lakuriqe
Gjithçka bëhet e dyshimtë:
përkëdheljet e kujtimeve, fshirjet e hijeve
Gjithçka bëhet aq e largët:
edhe prania e të dashurit.
Jeta jonë e huazuar zgjohet befas dhe e zbulon
çastin e kthimit:
nga pikëllimi e harrojmë mirënjohjen.
Më së rëndi është kur erret në pranverë.

Maria Wine:

GODMORGON

Godmorgon
min morgon!
Molnfri himmel
armar uppåt sträck.
Skugglösa drömmar
spinn själv nya.
Ansiktet
nej gå inte till spegeln
sök igenkännandets trygghet
någon annanstans.
Ljus och skugga står fadder åt dig
tavlan är svart
kritan vit
orden glöder i myrstacken
oskrivna dag
goddag min dag
skriv!

Marie Vine:

MIRËMËNGJES

Mirëmëngjes
i imi mëngjes!
Qiell pa re
shtrij duart përpjetë.
Ëndrrat pa hije
ritjerrni vetveten.
Fytyrë
mos shko te pasqyret
rehatinë e njohjes
kërko tjetërkund.
Drita e hija janë nunët tu
dërrasa e zezë
e shkumësi i bardhë
fjalët e zharitura mugullojnë
ditë e pashkruar
mirëdita o dita ime
shkruaj!

Torbjörn Schmidt:

SPRÅK

Tåget går över en gräns
och alla träd byter namn.
Alla träd, buskar, stenar, stigar
och färger byter namn, alla vägar;
husen byter namn, gräset heter något annat,
inte gräs,
vatten är inte längre vatten,
jord är inte jord.
Människorna döps på nytt
och människornas skuggor byter namn.

Tåget går in i ett nytt land,
människorna får nya namn, nytt språk,
alla, med sina hus och djur
under en väldig åskhimmel.
Här älskar människorna varandra
på ett annat språk.

Torbjörn Shmidt:

GJUHA

Treni kalon një kufi
të gjitha pemët ndërrojnë emër.
Të gjitha pemët, shkurret, gurët, shtigjet
dhe ngjyrat ndërrojnë emër, të gjitha udhët;
shtëpitë ndërrojnë emër, bari quhet ndryshe,
jo më bar,
uji nuk është më ujë,
toka nuk është më tokë.
Njerëzit pagëzohen sërish
dhe hijet e njerëzve ndërrojnë emër.

Treni hyn në një vend tjetër,
njerëzit marrin emra të ri, gjuhë të re,
të gjithë, me shtëpitë e kafshët e veta
nën qiellin e madh të përhirtë.
Këtu njerëzit e duan njëri-tjetrin
në një gjuhë tjetër.

Stig Larsson:

SNÖVIT

Varje natt kommer Du
att mördas. Just
innan du somnar
kommer den: staten,
inte den sammansatta, utan
den stora, den
värsta, sex vassa
bokstäver.

Stig Larson:

BORËBARDHA

Çdo natë
do të vrasin. Pak
para se të flesh
do të vie: shteti,
jo ai i ngratërruari, por
ai i madhi,
më i ashpri,
me gjashtë shkronja të mprehta. *

* Në gjuhën suedeze Borëbardha quhet SNÖVIT.
Pra, poeti e ka fjalën për këto gjashtë germa.

Lars Huldén:

JAG BLIR GAMMAL KÄRA DU

Gryningen kommer tyst tassande till mig,
sätter sig på min sängkant,
säger ingenting,
ser bara på mig
med allvarsamma ögon
och jag förstår:
dagar är viktiga,
dagar är korta,
dagar är få.

Lars Hulden:

PO PLAKEM E DASHUR

Mëngjesi çapit heshturazi drejt meje,
ulet te fundi i shtratit,
nuk thotë asgjë,
vetëm më vrojton
me sy seriozë
dhe unë e kuptoj:
ditët janë të rëndësishme,
ditët janë të shkurtëra,
ditë ka pak.

Elisabet Hermodsson:

IDEALISM

En lång rad vackra ord
utan vidhängande människor.

Elizabet Hermudson:

IDEALIZMI

Një varg i gjatë i fjalëve të bukura
pa njerëz rrethrotull.

Elisabet Hermodsson:

TÄNK PÅ DEM...

tänk på dem
som har så små hjärtan
att bergen inte
ryms i dem
poesins berg
och bergens poesi

Elizabet Hermudson:

KUJTOJ ATA...

kujtoj ata
që kanë zemra aq të vogla
sa që malet
nuk zënë vend në to
malet e poezisë
e poezitë e maleve

Barbro Lindgren:

ETT GRÄSSTRÅS LIV

Ett grässtrå
upplever inte mycket
av format
vissa stukas
kanske ständigt
under hårda sulor
vassa klövar
men reser sig igen
och vinden
ruskar om ibland
och kölden nyper till
på dagen är det ljust
om natten blir det mörkt
det gäller även marken.

Barbro Lindgren:

JETA E NJË FIJE BARI

Një fije bari
nuk përjeton aq shumë
me vlerë
disa ndrydhen
ndoshta përherë
nën sholla të forta
e kthetra të mprehta
por ngrihen përsëri
dhe era
i tund ndonjëherë
dhe cermi i kafshon
gjatë ditës është dritë
natën bie terri
njësoj është edhe në tokë.

Barbo Lindgren:

GRÅT INTE NÄR JAG ÄR DÖD

Gråt inte när jag är död
jag finns inom dig alltid.
Du har min röst
den finns i dig
den kan du höra
när du vill.
Du har mitt ansikte
min kropp.
Jag finns i dig
du kan ta fram mig
när du vill.
Allt som finns kvar
av mig
är inom dig
så vi är jämt tillsammans.

Barbo Lindgren:

MOS QAJ KUR TË VDES

Mos qaj kur të vdes
brenda në ty prore jam.
Ti e ke zërin tim
ai është në ty
mund ta dëgjosh
kur të duash.
Ti e ke fytyrën time
trupin tim.
Unë jam brenda në ty
mund të më marrësh
kur të duash.
Gjithçka që ende ka mbetë
nga unë
është brenda në ty
ja, pra, bashkë jemi gjithmonë.

Werner Aspenström:

ANTIAPARTHEID

Du i mitten
och en på var sida
hängda i sina celler.
Men du fri att gå ut
och förkunna.

Månen speglar sig i sjön.
Smärtan i tidningssidan.
Vinden svalkar några tak
och silar in genom väggarna.
Kunskapen sipprar in, kommer åt.
Medlidandet är ett tungt tak,
som inte ens stormen kan lyfta.

Du i mitten
och en och en
bryts de ner, grannarna.
Du ser dem förvandlas:
krympa av skuld
till alla dem
som tortyren tvingat dem
att förråda.

Du i mitten
och på vardera sidan
hängde de sig i sina celler.
Du säger: tryckstilarna i Europa
är för små att fånga
Sydafrikas lidande.

Verner Aspenström:

ANTIAPARTHEID

Ti në mes
dhe nga një në secilën anë
i varur në birucë të vet.
Por ti i lirë për të dalur
dhe dëshmuar.

Hëna pasqyrohet në liqe.
Dhembja në faqet e gazetës.
Era freskon ca çaste
dhe përshkon muret tejpërtej.
Njohtimet rrjedhin brenda, të kaplojnë.
Keqardhja është një kulm i rëndë,
as shtërngata s'e lot dot.

Ti në mes
dhe një nga një
thyhen, fqinjtë e tu.
Ti i sheh si transformohen:
si rrudhen nga faji
para tërë atyre
që tortura i ka detyruar
t'i tradhëtojnë.

Ti në mes
e në cilëndo anë
vareshin ata në biruca të veta.
Ti the: stilet e germave në Evropë
janë tepër të vegjël për ta zënë
vuajtjen e Afrikës së Jugut.

Werner Aspenström:

ELEGI

Ty, dagen lider
solen skall dö klockan sju.
Säg, experter på mörkret,
vem skall lysa oss nu?
Vem tänder ett västerländsk motljus,
vem drömmer en österländsk dröm?

Kom vem som helst med en lykta!
Helst du.

Verner Aspenström:

ELEGJI

Ja, dita po vuan
dielli do të vdes në ora shtatë.
Na thuaj ti, njohës i errësirës,
kush do të na argëtojë ne?
Kush do ta ndezë një dritë, andej kah perëndimi,
kush do ta ëndërrojë një ëndërr lindore?

Le të vijë kushdo me një llampë!
Por, më së shumti do të doja të vije ti!

Peter Curman:

DU ÄR RÄDD

Du är rädd
säger du
att jag ska överge dig
men det är inte jag
som överger.
Det är din rädsla
som förskjuter mig.
Därför ska jag ta den
försiktigt
som en fågelunge i min hand
inte heller den
ska jag överge.

Peter Kurman:

TI JE E FRIKËSUAR

Je e frikësuar
po thua se
unë do të braktisi
Por, unë nuk jam ai
që braktisi njeri.
Kjo është frika jote
që po më dëbon mua.
Prandaj, do ta marr atë
me kujdes
si një zogth në dorën time
dhe, as këtë
s'do ta braktisi.

Ingrid Sjöstrand:

ELDA...

Elda under din vrede
med maktens nyheter:
Dämpa inte din smärta
över livet
som stjäls ifrån oss
trösta inte din sorg
över världen
som våldtas
inför våra ögon.
Elda under din vrede.

Ingrid Shöstrand:

SHPRUSHE...

Shprushe zjarrin e zemërimit tënd
me lajme të pushtetit:
Mos e zbut dhembjen tënde
për jetën
që po na e vjedhin
mos e ngushëllo pikëllimin tënd
për botën
që po na e dhunojnë
para syve tanë.
Shprushe zjarrin e zemërimit tënd.

Sonja Åkesson:

JA, TACK!

En varm hand.
Ett varmt bo.
En varm kofta
att trä på de isande tankarna.
En varm kropp
att trä på kroppen.
En varm själ
att trä på själen.
Ett varmt liv
att trä på det isande livet.

Sonja Okeson:

PO, FALEMNDERIT!

Një dorë e ngrohtë.
Një fole e ngrohtë.
Një triko të ngrohtë
për t'i veshur mendimet e akullta.
Një trup të ngrohtë
për ta veshur trupin.
Një shpirt të ngrohtë
për ta veshur shpirtin.
Një jetë të ngrohtë
për ta veshur jetën e akullt.

Lars Lundkvist:

SYN

Har du sett en citrongul himmel
med gröna moln,

en blå skog
med svarta hästar i kritvit snö?

Har du sett den synen
någon gång?

Göm den då i sparlakansväv
i en ask av cederträ

och bär den vid hjärtat.
Du får aldrig se den igen.

Lars Lundkvist:

PAMJE

E ke parë qiellin e verdhë si limoni
me re të blerta,

dhe pyllin e kaltërt
me kuaj të zinj në borë të bardhë-shkumës?

E ke parë atë pamje
ndonjëherë?

Atëherë fshihe në shami të qëndisur
në një kuti qiparisi

dhe mbaje afër zemrës.
Nuk do ta shohësh kurrë më.

Lars Lundkvist:

OVISSHET

Kvinnan bär en sjal
med kopparspänne.

När hon sjunker ner genom jorden
kommer där fram en källa.

Träden lägger runt omkring den
sina frukter och blad

som bevattnas av skogens vilda djur
och vaktas av en orrhöna.

De som sjunger
är dolda i grönskan.

Fråga mig inte om andemeningen.
Fråga den Allsmäktige.

Lars Lundkvist:

PAQARTËSI

Gruaja lidh shallin
me kopsë bakri.

Kur ajo fundoset thellë nën tokë
aty del një burim.

Pemët lëshojnë përreth tij
frutat e fletët e veta

që ujiten nga kafshët e egra të pyllit
e ruhen nga pulegrat.

Ata që këndojnë
janë të strukur në blerim.

Mos më pyetni për kuptimin e fshehtë.
Pyetni të Gjithëpushtetshmin.

Rolf Aggestam:

SPADEN

I den här världen
står en spade lutad mot väggen.
Från norr kom en man
genom skogen.
Frågade: Var ska jag gräva?
Där! Svarade jag.

Rolf Agestam:

LOPATA

Në këtë botë
një lopatë qëndron e mbështetur për skaj të murit.
Nga veriu doli një njeri
prej malit.
Dhe pyeti: Ku ta hapi gropën?
Tutje, iu përgjigja unë.

Göran Tunström:

ETT PAR VITA VINGFJÄDRAR

Ett par vita vingfjädrar
har lämnat själva fågeln före sig.

De flyger ännu
sammanhållna
bara av vilja
och minnet.

En svag förnimmelse av riktning.

Varje fläkt
särar dem en aning.

Jëran Tunstrëm:

NJË PALË FLATRA TË BARDHA

Një palë flatra të bardha
e kanë lënë shpendin qëmoti.

Ato fluturojnë ende
mbahen bashkë
vetëm nga vullneti
dhe kujtimi.

Një vegim i brishtë i kahjes.

Çdo puhi
i ndan ngapak nga njëra-tjetra.

Bo Setterlind:

NÅGON DU KÄNNER

Någon du känner, är din bästa vän,
är beredd att ge dig allt
utan att begära någonting igen.

Någon du känner, har för dig idag
lagt ett ord av guld och har
utan att behöva, trätt till ditt försvar.

Någon du känner, vill dig alltid väl,
vill i nöd och glädje gå
hemlig vid din sida, aktsam om din själ.

Bu Seterlind:

DIKUSH QË TI E NJEH

Dikush që ti e njeh, është miku yt më i mirë,
i gatshëm që t'i falë të gjitha
asgjë pa të vdirë.

Dikush që ti e njeh, ka folur për ty
një fjalë të artë dhe prapë
pa patur nevojë, të ka mbrojtur si shkabë.

Dikush që ti e njeh, ta don veç të mirën,
don vetëm të mbetet, në gëzim e në vaj
fshehtas pranë teje, shpirtin të ta ruaj.

Siv Arb:

ENFALD-MÅNGFALD

Enfald
Mångfald
Gemenskap

Det är på väg över bron,
inte vid dess fästen,
som paradoxerna möts
och dialogen börjar.

Siv Arb:

NJËTRAJTSHMËRI-SHUMËTRAJTSHMËRI

Njëtrajtshmëria
Shumëtrajtshmëria
Bashkësia

Në rrugë e sipër mbi urë,
e jo te themelet e saj,
takohen pradokset
dhe fillon dialogu.

Helge Jedenberg:

KUNDE JAG SKRIVA

Kunde jag skriva
ett fullkomligt brev till dig
skulle orden
lysa som dina ögon
dofta som din hud
värma som dina händer
tona som din röst.

Mitt brev skulle vara
en skrift av ditt blod
en sång av din stämmas band
ett hjärta som bultar som ditt
av kärlek som ej söker sitt.

Ordet skulle
vara som vore det icke ord
vara detta som saknar ord
vara en bild av ditt väsens art
vara ett brev av fullkomlig art.

Kunde jag skriva
ett fullkomligt brev till dig
vore du själv mitt brev.

Helge Jedenberg:

TË MUND TË TË SHKRUAJA

Të mund të të shkruaja
një letër të përsosur
fjalët
do të ndriçonin si sytë e tu
do të kundërmonin si lëkura jote
do të ngrohnin si duart tua
do të tingëllonin si zëri yt.

Letra ime do të ishte
alfabet i gjakut tënd
këngë e pejzit të zërit tënd
zemër që rrah si ajo jotja
dashuri që s'i gjendet shoqja.

Fjalët
do të ishin sikur të mos ishin fjalë
do të ishin diçka që s'folet me fjalë
do të ishin pamja e qenies sate të tërë
letra më e përkryer aherë do ish bërë.

Të mund të të shkruaj
një letër të përsosur
letra ime do të ishte - ti vetë.

Erik Lindegren:

DRÖMMEN

Jag går vid stranden och söker spår
framtidens vackra spår
och vågens krona

jag ser stenar tumla och fåglar falla
och jag avstår mitt ord
åt tystnadens brus

jag böjer mig ner över törnrosedrömmen
och ger den min tanke
i hopp att den skall tänka på mig

Erik Lindegren:

ËNDRRA

Eci pranë plazhit dhe kërkoi gjurmë
gjurmët e bukura të ardhmërisë
dhe kurorën e valëve

shoh gurët tek vërtiten e zogjtë që bien
dhe ia lë fjalën time
shushurimës së heshtjes

përkulem mbi gjumin e princeshës së fjetur
dhe ia jap mendimin tim
me shpresë se do të mendojë për mua

Bengt Anderberg:

MOT DITT FÖNSTER...

mot ditt fönster i juninatten
stöder lätt min kind
allt har slutit sig och stillnat
hus och träd i drömmar stå:
men du ler helt sakta och din hand
vilar mot den svala fönsterbrädan
som du kände världens puls:
anar du hur någon i ett rum av ljus
glömmer skymningen för dig

Bengt Anderberg:

PRANË DRITARES SATE...

pranë dritares sate nata e qershorit
e mbështet lehtë faqen e vet
bota është mbështjellë kruspull e prehet
shtëpitë e pemët struken në ëndrra:
por ti qeshë krejt ngadalë dhe dora jote
pushon te dritarja e vakët
sikur ia mat pulsën gjithësisë:
a hamendësh, vallë, se si dikush në një dhomë drite
e ka harruar muzgun për ty

Vilhelm Ekelund:

EN OKÄND

fastän allting skiljer
är ett band emellan oss;
kunde känna dig bland tusen:
det som utsägbart strålar
om dig - darrande och vita,
djupa stilla
genius vid ditt huvud!

Vilhelm Ekelund:

NJERI I PANJOHUR

ndonëse gjithçka na ndanë,
kemi një fat të përbashkët;
do të njihja ndër njëmijë vetë:
atë që pashpjegueshëm rrezaton
nga ti - të dridhurin të bardhin
të thellin të qetin
gjeniun pranë kokës sate!

Olof Lagerkrantz:

VREDE GE MIG VINGAR...

Vrede ge mig dina starka vingar
att jag kunde flyga upp i bergen
undan denna lumpenhet och dumhet
till en äng där gräset lyser grönt.
Ren av evig snö är luften. Milsvitt
under mig all världen breder ut sig.
När mot kvällen jag skall återvända
äger jag ej vingar mer som bär mig.
Lugn i hjärtat stannar jag i bergen.

Ulof Lagerkrantz:

ZEMËRIM M'I JEP FLATRAT...

Zemërim m'i jep flatrat tua të forta
të fluturoj përpjetë bjeshkës
tutje prej kësaj amullie dhe marrie
te një lëndinë ku bari ndrin i blertë.
Ajri është i pastër nga bora e amshueshme. Shumë mila
nën mua shtrihet e tërë bota.
Kah muzgu kur duhet të kthehem
s'i kam më flatrat të më bartin.
Me zemër të qetë qëndroj në bjeshkë.

Karl Vennberg:

PROCESS

Bönerna
som man ändå inte ber
blir ödmjukare med åren.
Allt omständligare
vederlägger
varje bön den föregående.

Karl Venberg:

PROCES

Lutjet

që dhe ashtu nuk i thua
me vite bëhen gjithnjë e më të përvuajtura.
Gjithnjë e më padiktueshëm
e hedh poshtë
secila lutje atë të mëparshmen.

Bo Carpelan:

KVÄLLEN

Kvällen är vid gräset,
vilket rörs lätt av vindar.
Solen sänker sin eld
i molnet,
klar, utan stjärnor, är himlen.

Bu Karpelan:

MBRËMJA

Mbrëmja rri te bari,
që lëmohet lehtë nga erërat.
Dielli e fundos zjarrin e vet
ndër retë,
i kthjelltë, pa yje, është qielli.

Sandro Key-Åberg:

KÄRA LIV SKYND A DIG

Kära liv skynda dig
smula mig mellan dina handflator.
Maka mig samman
i din kupade hand
och för mig tätt till din mun.
Blås mig in mellan träden
ner över livets uppvända ögon
trakéer och hjärtblad.
Det är så kallt närmare månen
jag är så kär i jorden.

Sandro Key-Oberg:

JETË E DASHUR NGUTU

Jetë e dashur ngutu
më thërmo mes shuplakave tua.
Më palo
në dorën tënde të mbledhur
dhe më ço drejt gojës sate.
Më fryj pastaj nëpërmes pemëve
përmbi tërë sytë e kthyer përpjetë
mbi trake e barkushe.
Qenka ftohtë këtu afër hënës
sa e dua tokën.

Sven Alfons:

DITT HJÄRTA

Ditt hjärta, Gud, är modigt,
som tåler förorättas
av löv som viskar.

I vek belevnhet uthärdar du
orms kräl i paradiset
och vindens fågelflock
och havets snabba fiskar.

Helst drucke du
mild stiltje,
helst rörde ingen fisk
en fena i ditt hav,
helst låge du lik
skjuten duvokropp.

Ditt hjärta, Gud, är modigt,
som driver tusen floder blod
i orons blodomlopp.

Sven Alfons:

ZEMRA JOTE

Zemra jote, Zot, qenka e fortë
që duron ta fyej
pëshpërима e gjetheve.
Me pakujdesi të brishtë duron
zvarritjen e gjarpërit në parajsë
dhe turmat e zogjve të erës
dhe peshqit e shpejtë në det.

Do të doja ta pijsh
prehjen e qetë,
do të doja që as një peshk
të mos lëvizë në detin tënd,
do të doja të shtrihesh
si pëllumb i vrarë.

Zemra jote, Zot, qenka e fortë,
që i shtyen mijëra lumenj gjaku
nëpër venat e trazimit.

Rabbe Enckell:

ÄLSKA DETTA

älska detta:
isig strand
nakna stenar
och fågeln - den lilla lustvandrar
i risigt grenverk:
bland spillror av förlorat
paradis i sina vingar

Rabe Enkel:

DUAJE KËTË

duaje këtë:

plazhë të akullt

gurët lakuriq

dhe zogun - shtegtarin e vogël të pasioneve

ndër rrënjët e ngatërruara:

me dromcat e parajsës së humbur

në flatrat e veta

Per Westerberg:

APOKALYPS

Jag tänkte mig som barn
att om världen ginge under
så skedde det så här:
En jätte har en mörk sol
nere i sin mage.
När solen börjar brinna
i hans strupe en oväntad dag,
då sväljer jätten jorden
som en enda klunk vatten.

Per Vesterberg:

APOKALIPS

Si fëmijë mendoja
se nëse bota do të mbaronte
do të bëhej kështu:
Një vigan e ka një diell të errët
thellë në bark.
Kur dielli nis t'i djegë në fyt,
një ditë prej dite,
aherë vigani e përbin tokën
si një gllënkë të vetme uji.

Claes Andersson:

EN LITEN ISELKOTTSUNGE

En liten igelkottsunge
lapade sol mellan två solvarma
grästuvor.

Han sträckte på sig
och bara njöt.

Hans far var borta hans mor
var död.

Han njöt så helt och
utan förbehåll.

Han väntade på att tåget
skulle komma.

Lutade sitt lilla huvud
mot rälsen och lyssnade
till tåget
som närmade sig.

Klaes Anderson:

NJË ZOG IRIQI

Një zog iriqi
lëpinte rrezet mes dy shtëllungave të barit
të ngrohura në diell.
Shtriqej
dhe vetëm kënaqej.
I ati kish ikur e ëma
kish vdekur.
Ai kënaqej me mish e shpirt
pa u përmbajtur.
Priste që treni
të vijë.
E kish mbështetur kokën e vet të vocërr
mbi binarë dhe e përgjonte
trenin
që po afrohej.

Jan Gehlin:

GAMMALDAGS EROTIKON

som en fågel vill jag överflyga
detta landskap som är du

i skuggans snabba märken
kan jag följa flykten utan spår

en pilsnabb skyttel genom gräset
väver samman trakter där jag går

som en vind mot vattenspegeln
vattrar flykten ytan som jag når

försvunnen plötsligt i en källa
dold av kvällens djupa skugga

går i lä av skog och kullar
fågeln söker aftonvila

Jan Gehlin:

EROTIKON NË STIL TË VJETËR

si zog dua ta kaptoj
këtë relief që je ti

në shenjat e shpejta të natës
mund ta ndjek ikjen pa gjurmë

një drugëz si shigjetë nëpër bar
i thurr në avlëmend trevat ku çapis

si puhi mbi pasqyrë uji
trazon ikja sipërfaqen që unë prek

tretur befas në një burim
fshehur prej hijes së thellë të muzgut

dremitem nga pyjet e kodrinat
zogu kërkon prehjen e mbrëmjes

Björn Håkansson:

LIMBO

Inte heller kärleken förmår något
mot denna tilltagande förlamning.

Först trodde jag att det var en sjukdom.
Sen sökte jag tröst i att jag ändå levde.

Nu utgör jag köttvikten i en främmande kropp
och väntar bara på att den ska andas färdigt.

Björn Hokanson:

L I M B O

As dashuria nuk arrin gjëkund
para kësaj shtangie në rritje.

Së pari mendoja mos ish sëmundje.
Pastaj gjeta ngushëllim se ende isha gjallë.

Tash jam vetëm një copë mish në një trup të huaj
dhe pres që ai ta lëshojë frymën e fundit.

Björn Håkansson:

TRIPTYK II: MELLAN GRÄNS OCH GRÄNS

Årstiden förråder sig i trädens färger:
fontäner av rött och gult med bruna accenter.
Också tevens trottoarer färgas röda.

Det är krig mellan utbytbara, bröder och systrar
som följer sitt samvetes röst och försvarar en gräns
mellan hjärta och hjärta, mellan tro och tro.

Blicken är där, zoomar in en krossad hjärna, attackerar
en flyktingström, våldtar ett barn per helikopter.
Nyss: ett gränslöst land, en slätt, där skilda

folkslag rört sig fritt mellan vi och oss, tanklöst
eller i kärlek. Nu: en gräns, och tusen gravar.
Miserere, varje nyfödd blir soldat i en hämndens armé.

Björn Hokanson:

TRIPTIK II: NDËRMJET KUFINJVE E KUFINJVE

Stina tradhëtohet nga ngjyrat e lisave:
fontana e së kuqes dhe së verdhës me thekse të murme.
E trotuaret e televizionit ngjyrosen me të kuqe.

Është luftë e ndërrueshmërive, vëllezërve e motrave
që e ndjekin zërin e ndërgjegjes dhe e mbrojnë një kufi
mes zemrës e zemrës, mes besimit e besimit.

Pamje të zmadhuar na afron vështrimi atje: një rrashtë të thyer,
sulmin
e një vargani ikanakësh, dhunohet një fëmijë me helikopter.
Rishtazi: një vend pa kufinj, një fushë, ku lloj-lloj

popuj lëviznin lirisht mes neve e nesh, pa mend
apo në dashuri. Tashti: një kufi, dhe mijëra varre.
Mjerim, çdo foshnje bëhet ushtar në ushtrinë e ahmarrjes.

Björn Håkansson:

NY JORD

Ljuset över din skuldra
när du står framför spegeln.
Du är en dröm, och en erfarenhet,

en gräns och, ett landskap
där minnet färdas fritt, och nuet
gör sin dagliga resa.

Och jag som förfäktat historiens död!
Din kropp säger emot: i din närvaro
har jorden åter börjat snurra.

Björn Hokanson:

TOKË E RE

Drita pas supit tënd
kur rri para paqyrës.
Ti je dritë, dhe përvojë,

kufi, dhe peisazh
ku kujtimi udhëton i lirë, dhe e tashmja
e bën rrugën e vet të përditshme.

E unë, që e predikoja vdekjen e historisë!
Trupi yt kundërshton: në praninë tënde
toka ka zënë të sillet përsëri.

Björn Håkansson:

I LÅGAN

Stillheten söker en form
finner ett ljus, en låga som inte fladdrar.
Låta tiden vara, inte
jaga den
i lågan finna lugnet.
Och när lågan slocknar
återfinna den i mörkret,
finna sig
som mörker, och våga
låta sig tändas

Björn Hokanson:

NË FLAKË

Prehja kërkon formë
e gjen një dritë, një flakë që s'dridhet.
Lëre kohën të rrijë, mos
e ndjek
në flakë gjeje qetësinë.
E kur flaka të fiket
gjeje sërish në errësirë,
gjeje veten
si errësirë, dhe guxo
ta lësh të ndezet

Björn Håkansson:

SANNINGENS MINUT

Kan sanningen segra?

Kan du hitta orden med strålkastare mot ögonen,
händerna bakbundna,
ensam på en scen där liken staplats
och publiken under tystnad registrerar varje
ryckning
i din kropp?

Jag är ingen profet, jag bara
extrapolerar ur ett trängt läge:
Sanningen gör oss inte fria
det är friheten som gör vårt öde
sant emot oss själva
mitt på scenen, bortom ironin.

Hur mycket tål dina ögon
hur mycket tystnad
hur många gudar
hur många döda?

Frukta det!
Frukta det ögonblick
då applåderna brakar löst!

(Till minnet av Karl Vennberg)

Björn Hokanson:

MINUTI I SË VËRTETËS

A mund të fitoj e vërteta?
A mund t'i gjejsh fjalët me dritëhedhësin në sy,
Duart e lidhura pas shpine,
fill vetëm në një skenë ku stivohen kufomat
e publiku e regjistron në heshtje
çdo dridhje
të trupit tënd?

Nuk jam profet, veç
po skicoj me kujdes nga një gjendje e nderë:
E vërteta nuk na çliron
mu liria na e bënë fatin
vërtetësisht kundër vetvetës
në mes të skenës përtej ironisë.

Sa durojnë sytë e tu
sa heshtje
sa hyjni
sa të vdekur?

Druaj!
Druaji momentit
kur shpërthejnë duartrokitjet!

(Për kujtim të Karl Venbergut)

Björn Håkansson:

SORGEN

Kallas sorg, en frusen klump
som stulit kroppen obesedd
med övergivna röster kretsande
i schaktet för försvinnande
och stum musik. Aldrig mer
är livet liv som innan. Och döden
är en dvärg i denna jätte.

Björn Hokanson:

PIKËLLIMI

Quhet pikëllim, një boçë e ngrirë
që ta vjedhë trupin padiktueshëm
me zëra të braktisur që vërtiten
rreth pusit për zhdukje
e muzikë memece. Kurrë më
jeta s'është si më parë. Dhe vdekja
është një xhuxhe në këtë vigan.

Björn Håkansson:

ANSIKTET

Ett ansikte träder fram ur dimman,
ur slöjorna.
nu är kropparna brända,
nu är allting hämnat.
Ur dimman träder det fram, ur rökarna,
otydligt ännu, ögonlöst
men på väg mot synen, utåt, hitåt
i en böljande rörelse,
som om det sökte sina egna drag
i en klarare spegel
hos mig.
Det är för mycket begärt:
att den som bara har sett
ska hjälpa den bländade se.
I rökarna svept, i stanken
måste jag vända mig bort.
Och allt
kan börja om igen.

Björn Hokanson:

FYTYRA

Një fytyrë shfaqet nga mjegulla,
matanë perdeve.
Tash janë djegur trupat,
tash është nxjerrë haku për të gjitha.
Nga mjegulla shfaqet, nga tymet,
ende e pakthjelltë, e pa sy
por për rrugë drejt shikimit, jashtë, këtej
me lëvizje valore,
sikur i kërkon konturat e veta
te një pasqyrë më e kthjelltë
te unë.
Kësaj i thonë të kërkosh tepër:
sikur ai i cili vetëm ka parë
t'i ndihmojë të verbuarit të shohë.
Mbështjellë në tyme, në kutërbim
më duhet ta kthej shpinën.
Dhe gjithçka
mund të fillojë përsëri.

Björn Håkansson:

UTAN APPELL

Ge och ta, vad återstår?
Aldrig kommer du tillbaka, aldrig
blir du hud igen
och andas mot min nacke.
Och namnet?
Någon eller icke någon.
Det stora skallet drar förbi och sedan,
i en skuggas dröm
slår stenens lås igen.

Björn Hokanson:

PA APEL

Jep e merr, çka mbeti?
Ti nuk kthehesh kurrë më, kurrë
s'bëhesh më lëkurë përsëri
që frymon mbështetur në qafën time.
Dhe emri?
Dikush apo askush.
Lehja e madhe kaloi pranë e pastaj,
në hijen e një ëndërre
u mëshel dryri i ngurtë përsëri.

Lars Forsell:

JAG SOVER I DIG

Jag sover i dig
Det kan du inte veta
Nära födelsen sover jag
Och nära det förtrollade

Du vänder dig i sängen
Som en havande val
Som ett plankton med stora ögon
Slumrar jag i dig

Jag älskar dig
Det får du aldrig veta
Nära döden sover jag
Och spränger mina skal

Lars Forset:

PO FLEJ BREND A TEJE

Unë flej brenda teje
Këtë ti nuk mund ta dish
Afër lindjes po flej
Dhe afër të magjishmes

Ti kthehesh në shtrat
Si balenë shtatzënë
Si plankton me sy të mëdhenj
Dremitem unë përbrenda teje

Të dua
Këtë s'do ta marrësh vesh kurrë
Afër vdekjes po flej
Dhe po i çaj gëzhojat e mia

Sten Jakobsson:

ATT VAKNA EFTER DIG

När jag vaknar är rummet
På drift. Kärleksnattens färger
har målat väggarna nya
sinnena stryker de på nytt
med sina sanslösa gärningar

Vid frukost upphöjer jag mig till ett öga
som ser
fast i trance

Jag hoppar på stenarna
över en flod
mellan kärlekens och dödens strömmar

Jag hoppar över hemliga
makter
frukterna efter deras handlingar:
Denna natt

Sängen
ett torg med drömmar
Mellan kärlekens och dödens strömmar

Sten Jakobson:

KUR ZGJOHEM PAS TEJE

Kur zgjohem dhoma ka lojtur
menç. Ngjyrat e natës së dashurisë
i kanë lyer muret rishtazi
shqisat i fërkojnë përsëri ata
me bëmat e veta të krisura

Në kaftjall e lartësoj veten në sy
që sheh
ndonëse në trans

Hudhem mbi gurë
mbi një lum
mes rrymave të dashurisë dhe vdekjes

Hudhem mbi fuqi
të fshehta
fryt i veprimeve të tyre:
Kjo natë

Shtrati
një shesh me ëndrra
mes rrymave të dashurisë dhe vdekjes

Peter Bergman:

MEDUSA

Dig såg jag liksom Perseus i en spegel:
ditt ormhuvud med ögonen förstenar
allt de ser. Dig såg jag indirekt.
Du såg inte mig.

Den kampen vann jag. Men jag fick
betala ett högt pris. Förstenad blev jag.
Spegeln, gesten, metaforen som en gång
räddade mig, tvingar sig kvar i mig.

Jag kan inte röra mig utan dem.
Förstenad blev jag själv i en spegel,
en gest, en atmosfär, en varelse med
djupa ögon som förstenar allt jag ser.

Peter Bergman:

MEDUZA

Të pashë si Perseu në një pasqyrë:
kokën tënde gjarpërore me sytë që ngurtësojnë
gjithçka që shohin. Të pashë tërthorazi.
Ti mua s'më pa.

Atë luftë e fitova. Por m'u desh
të paguaj çmim të lartë. U ngutësova.
Pasqyra, gjesti metafora, që më parë
më shpëtuan, tash gjëllijnë detyrimisht në mua.

Nuk mund të lëvizë më pa to.
I ngurtësuar u ktheva vetë në pasqyrë,
në gjest, në atmosferë, në një krijesë
me sy të thellë që ngurtëson gjithçka që sheh.

Peter Bergman:

ALL DIKT ÄR BEDRÄGERI

All dikt är ett sken, någon som inte finns.
Diktaren är en ljuskälla som speglas
och når oss genom spegelns ljusförstoring.
Det är inte verklighet. Det är magi,
och kan förvända synen på oss med sitt sken.
Men vad är egentligen ett sken?
Något som lyser i mörkret.

Peter Bergman:

ÇDO POEZI ËSHTE NJË MASHTRIM

Çdo poezi është iluzion.

Poeti është burim drite që pasqyrohet
dhe na arrin përmes rritjes së dritës në pasqyrë.

Kjo nuk është realitet. Kjo është magji,
dhe mund të na i shtrembërojë sytë me dritën e vetë.

Po, ç'është drita në të vërtetë?

Diçka që ndriçon në errësi.

Peter Bergman:

FRIHET

Balans är kunskapen om det man vet
och inte vet. Jämlikheten innebär att
det finns gränser mellan mig och dig:
att vi båda har hemliga landskap
om vilka den andra ingenting vet.
Vi är inramade av jämbördighet.

Nattens gränser är natten.
Våra är medvetenhet.
Jag vill vara jag och du, du
i gemensamhet.

Peter Bergman:

LIRITË

Balansi është njohuria për ato që i di
e s'i di. Barazia domethënë se
ka kufinj mes meje e teje:
se ne të dy kemi vise të fshehta
për të cilat tjetri s'di asgjë.
Ne ekzistojmë në korniza barazie.

Kufinj të natës i vë nata.
Tanët i vë vetëdija.
Unë dua të jem unë, e ti ti
bashkarisht.

Peter Bergman:

ETT INGENTING, EN VIND

Det är inte havet du hör, det är ingenting,
ingentings brus. Det är en känsla bara,
som snart rinner förbi. För allt försvinner, tunnas ut,
utplånas av tiden.

Metodiken varierar förstås: fyrarna slocknar
och musiken tystnar. Ändå hör man något.
Men det finns inte längre.
Bara ett ingenting, en vind.

Peter Bergman:

NJË ASGJË, NJË ERË

Nuk është ky deti që po e dëgjon, është asgjë, shushurima e asgjës. Është veç një ndjenjë që shpejt do të rrjedhë tutje. Se gjithçka zhduket, tëhollohet, zhbëhet nga koha.

Metodika ndryshon, kuptohet: fanarët fiken dhe muzika heshtë. Megjithatë diçka dëgjohet.

Por, nuk ka mbetur më asgjë.

Veç një asgjë, një erë.

Peter Bergman:

DU SOVER

Jag ser på dig där du sover.
Det lilla huvudet utanför täcket:
en fågel. Det finns i det lilla.

Du är min älskade. Det hör också
till. Det var inte självklart så,
men det blev så. Du sover.

Peter Bergman:

TI PO FLEN

Të shikoj atje ku po flen.
Koka e vogël jashtë mbulojes:
një zog. Ti ekziston në të voglën.

Ti je e dashura ime. Kjo duhet
ditur. Nuk ishte fare e qartë në fillim,
por kështu ndodhi. Ti po flen.

Ebba Lindqvist:

GÅVA

Jag ville ge dig en gåva
Jag gett till ingen förut.
Så ger jag dig min ensamhet
Den varar till livets slut.

Eba Linkvist:

DHURATA

Dëshiroj të të ta jap një dhuratë
Që s'ia kam dhënë askujt më parë.
Pra, po ta jap vetminë time
E cila do të zgjasë deri në fund të jetës.

Tomas Tranströmer *

TVÅ STÄDER

På var sin sida om en sund, två städer
den ena mörklagd, ockuperad av fienden.
I den andra brinner lamporna.
Den lysande stranden hypnotiserar den mörka.

Jag simmar ut i trance
på de glittrande mörka vattnen.
En dov tubastöt tränger in.
Det är en väns röst, tag din grav och gå.

Nobelpristagare, år 2011

Tomas Tranströmer *

DY QYTETE

Dy qytete, secili në anën e vet të ngushticës,
njëri i errësuar, i pushtuar nga armiku.
Në tjetrin ndriçojnë llambat.
Qyteti i ndriçuar e magjeps të errësuarin.

Notoj në trans
mbi ujin e errët që shkëlqen.
Ndihet një ushtimë e shurdhër e tubës.
Është zëri i një miku, merr varrin tënd dhe ik.

Fitues i çmimit Nobel për vitin 2011.

Tomas Tranströmer:

MIDVINTER

Ett blått sken
strömmar ut från mina kläder.
Midvinter.
Klirrande tamburiner av is.
Jag sluter ögonen.
Det finns ett ljudlös värld
det finns en spricka
där döda
smugglas över gränsen.

Tomas Tranströmer:

MESDIMRI

Një dritë e kaltërt
Shpërthen nga rrobat e mia.
Mesdimri.
Rraptimë e tamburinës së akullit.
Mbyllë sytë.
Është një botë e pazë
një e çarë
nga e cila të vdekurit
përvidhen tinëza nëpër kufinj.

Tomas Tranströmer:

LANDSKAP MED SOLAR

Solen glider fram bakom husväggen
ställer sig mitt i gatan
och andas på oss
med sin röda blåst.
Innsbruck, jag måste lämna dig.
Men i morgon
står en glödande sol
i den halvdöda grå skogen
där vi skall arbeta och leva.

Tumas Tranströmer

PEJSAZHË ME DIEJ

Dielli del prapa murit të shtëpisë
qëndron në mes të udhës
dhe merr frymë mbi ne
me frymëmarrjen e vet të kuqe.
Insbruk, unë duhet të ik nga ti. *
Por nesër
qëndron një diell i ndezur prush
në pyllin gri, gjysmë të vdekur
ku ne do të punojmë dhe jetojmë.

* Insbruk, qytet në Austri.

Tomas Tranströmer:

APRIL OCH TYSTNAD

Våren ligger öde.
Det sammetsmörka diket.
krälar vid min sida
utan spegelbilder.
Det enda som lyser
är gula blommor.
Jag bärs i min skugga
som en fiol
i sin svarta låda.
Det enda jag vill säga
glimmar utom räckhåll
som silvret
hos pantlånaren.

Tumas Tranströmer:

PRILLI DHE HESHTJA

Pranvera shtrihet e djerrë.
Hendeku zi si futa
zvarritet përlesh meje
pa reflektuar aspak.
Të vetmet që ndriçojnë
janë lulet e verdha.
Mua më bartë hija ime
siç bartet violina
në kutinë e saj të zezë.
E vetmja gjë që do të doja ta thoja
shkëlqen paarritshëm
si argjendi
tek pengmarrësi.

Tomas Tranströmer:

NATTBOKBLAD

Jag landsteg en majnatt
i ett kyligt månsken
där gräs och blommor var grå
med doften grön.
Jag gled uppför sluttningen
i den färgblinda natten
medan vita stenar
signalerade till månen.
En tidrymd
några minuter lång
femtioåtta år bred.
Och bakom mig
bortom de blyskimrande vattnen
fanns den andra kusten
och de som härskade.
Människor med framtid
i stället för ansikten.

Tomas Tranströmer:

FLETË NGA LIBRI I NATËS

Zbrita një natë maji
në një vezullim të ftohtë të hënës
ku bari dhe lulet ishin gri
por aroma e blertë.
Rrëshqita tatpjetë kah fundi
në këtë natë ngjyrë qorre
ndërsa gurët e bardhë
e lajmëronin hënën.
Një hapsirë kohore
disa minuta e gjatë
pesëdhjetetë vjeç e gjerë.
Dhe pas meje
përtej atyre ujërave që vezullojnë ngjyrëplumbi
ishte bregu tjetër
dhe ata që sundonin.
Njerëz me të ardhme
në vend të fytyrës.

Përmbajtja - Innehållet:

Dy fjalë për poezitë e përkthyer
Ett par ord om de översatta dikterna

Gustaf Fröding

Karin Boye

Elsa Grave

August Strindberg

Edith Södergran

Verner von Heidenstam

Göran Palm

Erik Blomberg

Pär Lagerkvist

Elmer Diktonius

Göran Sonnevi

Johannes Edfelt

Bertil Malmberg

Artur Lundkvist

Bosse Parnevik

Gunnar Ekelöf

Maria Wine

Torbjörn Schmidt

Stig Larsson

Lars Huldén

Elisabet Hermodsson

Barbro Lindgren

Werner Aspenström

Peter Curman

Ingrid Sjöstrand

Sonja Åkesson

Lars Lundkvist

Rolf Aggestam

Göran Tunström

Bo Setterlind

Siv Arb

Helge Jedenberg

Erik Lindegren

Bengt Anderberg

Vilhelm Ekelund

Olof Lagerkrantz

Karl Vennberg

Bo Carpelan

Sandro Key- Åberg

Sven Alfons

Rabbe Enckell

Per Westerberg

Claes Andersson

Jan Gehlin

Björn Håkansson

Lars Forsell

Sten Jakobsson

Peter Bergman

Ebba Lindqvist

Tomas Tranströmer

POEZIA SHQIPE NË SUEDISHT - ALBANSK POESI PÅ SVENSKA
(POESIA SUEDEZE NË SHQIP - SVENSK POESI PÅ ALBANSKA)

ZGJODHI DHE PËRKTHEU
I URVAL OCH ÖVERSÄTTNING AV

SHQIPTAR OSEKU

Korrektörë-lektorë
për poezitë e përkthyerë në gjuhën shqipe

Shefki Oseku
dhe
Ulmar Kvik

KONTROLL OCH KORREKTURLÄSNING
för dikterna på svenska språket

Ullmar Qvick
och
Marianne Bengtsson

Kompjuterizimi
Dataansvarig

Frashër Oseku

Botimi i shtatë, i përmirësuar

Sjunde förbättrade upplagan

U dorëzua në shtyp në shkurt të vitit 2002
Tryckning i februari 2002

**BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG - SUEDI
UTGIVEN AV TIDSKRIFTEN "DRITA" I TRELLEBORG – SVERIGE**

Për ndihmën e pakursyer, e falenderoj përzemërsisht:

Nise Martinsonin

dhe

Arne Nilsonin,

të dytë nga Treleborgu-Suedi.

**Kryeredaktori i revistës DRITA, në Treleborg të Suedisë:
Shefki Oseku.**

Ett stort tack till:

Nisse Martinsson

och

Arne Nilsson

båda från Trelleborg-Sverige

för all hjälp

**Shefki Oseku, chefredaktör för den albanska tidskriften
DRITA i Trelleborg-Sverige.**

Ju prezentojmë poetët bashkëkohorë shqiptarë - në suedisht

Dy fjalë për poezitë e përkthyer

Lexuesve suedezë po i jepet rasti që t'i përjetojnë shqetësimet e poezisë bashkëkohore shqipe, të përkthyer në gjuhën e tyre. Disa nga autorët, krijimet e të cilëve kësaj here janë zgjedhur për botim, janë emrat më eminentë në panteonin e letrave shqipe dhe bëjnë pjesë ndër lirikët më modernë shqiptarë.

Për të sfiduar sadopak kureshtjen Tuaj, por edhe mësimet e ngurta të kritikës letrare, i jemi shmangur prezentimit të të dhënave për autorët e poezive. Mendojmë, thjeshtë, se arti i njëmendtë nuk do kthjellime të mërzitshme biografike a kronologji tërkuzë datash e ditësh, po përkundrazi. Kur i flet të dashurit njëmijenjë kotërsira rreth objektit të gjakimit të vet, mundet që t'ia vjedhë me të padrejtë tërë trazimin e ëmbël të njohjes me të dashurën.

Jemi të bindur se: arti i njëmendtë e gjen vet shtegun më të shkurtër drejtë zemrës njerëzore. Ai nuk do ndihmë, nuk do kthjellime dhe, mbi të gjitha, si çdo dashuri e flaktë, nuk do arsyë – ai do vetëm hapësirë të lirë dhe afrim me burimin e pasionit.

Dhe ne ashtu Ju lamë...

Përkthyesi: Shqiptar Oseku

En presentation av nutida albanska diktare - på svenska språket

Ett par ord om de översatta dikterna

Vi ger härmed till svenska läsare en möjlighet att på svenska språket uppleva den albanska poesins bekymmer. Några av de författare, vars verk vi denna gång valt att publicera, tillhör de mest framstående namnen på den albanska litterära parnassen och tillhör den nutida albanska lyriken.

För att i någon mån trotsa Er nyfikenhet och samtidigt den hårda litteraturkritikens omdömen, har vi avstått från att presentera uppgifter om dikternas upphovsmän. Vi menar helt enkelt att den verkliga konsten inte kräver några ledsamma biografiska förklaringar eller en kronologisk rad av data utan tvärtom. Om hon säger ett tusen och en banaliteter till sin älskade om föremålet för sin längtan, då kan hon därmed utan avsikt helt slita sönder den ljuva sällhet som funnits i hans bild av den älskade.

Vi är övertygade om en sak: Den verkliga konsten finner på egen hand den kortaste vägen in i människohjärtat. Den behöver ingen hjälp, ingen förklaring och framför allt – liksom i varje glödande kärlek – inga sakskaäl. Den kräver bara fritt utrymme och en närhet till passionens källa.

Och med detta lämnar vi Er...

Översättaren: Shqiptar Oseku

Këto poezi autori i ka përkthyer dhe botuar gjatë viteve 1994 – 2000, në Revistën "Drita" që ishte botim i shoqatës "BESA" në Treleborg të Suedisë. Por, poashtu, edhe në gazetën "Besa" që botohej në Suedi.

Dessa dikter har författaren översatt och publicerat under åren 1994 –2000 i tidskriften "Drita" som utgavs av föreningen "BESA" i Trelleborg, i Sverige. Likaså i tidskriften "Besa" som även den utgavs i Sverige.

Ismail Kadare:

ATJE LARG, NË VERI

Atje në Veri

Atje larg nën retë bojë hiri

Ndodhet një qytet me një emër të tmerrshëm,

të përgjakur.

Shirat bien parreshtur mbi qytetin verior, Gjakovë,

Po, siç duket, nuk e lajnë dot gjakun nga fytyra e tij.

Ismail Kadare:

LÅNGT UPPE I NORR

Där uppe i norr
Långt borta i fjärran under de gråa molnen
Ligger en stad med ett fruktansvärt blodigt namn.

Regn faller alltid över den nordliga staden Gjakova, *
Men det kan ej skölja bort blodet från dess garvade ansikte.

* Gjakova, Det blodiga fältet. En stad i Kosova.

Ismail Kadare:

ÇAJLD HAROLDI

Kalanë e Tepelenës unë e pashë:
E shkretë ish, bedenat pa njeri.
As roje, as shtiza, as emri Ali Pashë.
Më nuk kumbon. Por heshtje. Qetësi.

Nuk pashë un'as zjarre sipër kullash,
As kuaj, as llambada mbi xhami,
Por pashë tek libraria, anës udhës
Si blinte "Çajld Haroldin" një fëmijë.

Ismail Kadare:

CHILD HAROLD *

I Tepelena såg jag borgen:
En ökenmark, där inte en röst ljud.
Ej vakter, ej hillebarder, och sorgen
Efter Ali Pascha som var död. *

Jag såg ej eldar på vaktorn,
Ej hästar och ljussken i moskén,
Blott hur ett litet gossebarn
"Child Harold" köpte och förbi ven.

* På 1800 - talet gjorde Ali Pascha, en mäktig albansk adelsman känd som Lejonet från Janina, uppror mot den turkiska överheten och tände gnistan i den grekiska frigörelsekampen. Han och albaner nämnes även av b.l.a. den engelske lord Byron, som besökte Grekland under de grekisk - turkiska striderna.

Ismail Kadare:

PLAZHET NË DIMËR

Shtirirë para nesh humbëtirë e plazheve,
hapësirë e gjerë si në poemat e Naim Frashërit.

Plazhet të mbetura bosh pa stinën e verës
u ngjajnë guacave që iu kanë marrë perlat.

Përbri tyre lokomotivat fishkëllejnë së largu,
tek tërheqin trenat plot me mollë të lagëta.

Ismail Kadare:

STRÄNDER I VINTER

Långt framför mig ligger strändernas ödemark,
breda vyer som i Naim Frasheris dikter.

Stränder som tömts efter sommarsåsongen
liknar musslor som har blivit av med sina pärlor.

Bredvid dem visslar tågen från fjärran,
vagnar fulla av regnblöta äpplen.

Ali Podrimja:

UNË BIRI YT

Unë biri yt, Kosovë, t'i njoh dëshirat e heshtura
t'i njoh ëndrrat tua, erërat e fjetura me shekuj,

t'i njoh vuajtjet, gëzimet, vdekjet,
t'i njoh lindjet e bardha, caqet e tua të kallura;

ta di gjakun që të vlon në gji,
dallgën që të rrah netëve të pagjumta
e të shpërthenë si vullkan

më mirë se kushdo tjetër të njoh, Kosovë,
unë, biri yt.

Me shekuj e kam shitur gjakun
e rritur jam me gjakun e shitur.

Me shekuj kam hëngër veten
e ditur s'kam të qeshë me veten e tepruar.

Miq,

Kosova është gjaku im që nuk falet.

Ali Podrimja:

JAG DIN SON

Jag din son, Kosova, känner din tysta längtan
dina drömmar, dina vindar som sovit i sekler,

jag känner dina umbäranden din glädje och död,
dina vita gryningar, dina brända gränser;

jag känner blodet som kokar i ditt bröst,
vågor som slår mot dig i sömnlösa nätter
och vill bryta ut som en vulkan

jag känner dig bättre än någon annan, Kosova,
jag, din son.

I sekler har jag fått sälja mitt blod
och har vuxit av blod som sålts.

Sekler har tårt på mig

och har inte vetat att skratta åt mitt överblivna jag.

Vänner,

Kosova är mitt blod som inte kan skänkas.

Ali Podrimja:

PIKËLLIMI

Unë nuk qaj
shi bie vogëlushi im
shkundet plepi i shtëpisë.

Unë nuk këlthas
nën dritare vogëlushi im
coft ra korbi i Edgar Allan Posë.

Unë nuk luaj vendit
muret lëvizin sendet vogëlushi im
vjeshtë e keqe mori.

Re e zezë shtëpinë tonë mbështoll.

Ali Podrimja:

SORG

Jag gråter inte
det regnar min son
poppeln skakar i vår trädgård.

Jag ylar inte
vid fönstret min son
Edgar Allan Poes korp föll livlös.

Jag flyttar inte på saker
väggarna flyttar på saker min son
det här blev en ond höst.

Mörkrets moln har fallit över vårt hem.

Ali Podrimja:

MORA UDHËN TË TAKOJ NJERI

Mora udhën
të takoj Njeri në grumbull
në Shanzelize fjala vjen
apo në Kremlin
po vite u bënë që kërkoj
dhe që s'flas.

Ali Podrimja:

JAG RESTE FÖR ATT
TRÄFFA MÄNNISKAN

Jag reste i väg
för att träffa Människan i mängden
I Champs - Elysées till exempel
eller i Kreml
Sedan åratals letar jag efter Människan
och säger ingenting.

Ali Podrimja:

FLETË E BARDHË

Mbi tavolinë

fletë e bardhë. Aty do shkuar:

Lum Podrimja vdiq më 29 shtator 1982.

Por, unë nuk mund ta nënshkruaj vdekjen tënde.

Në qenie të ndjej si lëvizë, si merr frymë

të shoh në jetë

gjithkund.

Vdekjen tënde nuk mund ta nënshkruaj vogëlush.

Varrmihësit le ta qesin emrin

ose bardhësia le të më mbulojë edhe mua

të tërin.

Ali Podrimja:

VITT BLAD

På bordet
ett vitt blad. Det skall stå:
Lum Podrimja dog den 29 september 1982.

Men jag kan inte skriva under din död.

I mitt väsen känner jag hur du andas
jag ser dig vid liv
överallt.

Din död kan jag ej skriva under min son.

Dödgravarna får skriva ditt namn
eller så får denna vithet täcka även mig
hela mig.

Martin Camaj:

SHKODRA

Aty si tash, para se me ardhë fiset,
ishe
me tambël në plasaritjen e currave
e me themele në ujin e njelmë.
Të dhanë vetëm një emër: Shkodra
e të thirrën qytet me kunora
e të hodhën përkrye gur
e hekurat para.

U zgjove e përgjakun sa herë
e u këqyre në pasqyrën tande.
Me emën grueje u lave ndër ujna të kthjellta
t' lumejve edhe ndeje me petka të reja
mbi shkamb

e ndritun ballë diellit mbi fusha.

Martin Camaj:

SHKODRA

Då såsom nu, fanns du där förut,
långt innan stammar kom
med mjölk och honung rinnande i dina älvar
och med grunden djupt ner under salta vattenmassor.
De gav dig enbart ett namn: Shkodra
och kallade dig staden med kransarna
och kastade stenar på dig
och du fick de första handbojorna.

Du väcktes blodig upprepade gånger
och såg dig själv i din sjö, i din spegel.
Din kvinnliga stolthet tvättade du ren i dina älvars blåaste
vatten
och med nya kläder stod du alltid intill klipporna
skinande ljus under den lysande solen.

Fredrik Reshpja:

SHQIPONJA

U kthye shqiponja në fole dhe ra të flejë
sytë i mbylli:

vështrimi i fundit ra ngadalë
mbi malet, mbi stuhinë e gurtë të shkëmbinjëve.

Me plot mbrëmje, ëndërron në qetësi
mjegulla, që digjen në perëndim, perde shiu...

U kthye shqiponja në fole dhe ra të flejë.
Qerpikët e egër i uli si heshta pas peisazheve
të dashura.

Frederik Reshpja:

ÖRNEN

Örnen vände till boet för natten
och slöt sina ögon:

sista blicken föll långsamt
över berg, över de hårda stormpiskade klipporna.

Med ögonen fulla av skymning drömmer den
dimmor, som nalkas i väster, regnridåer...

Örnen vände till boet för att sova.
Ögonlocken sänktes som sköldar
över de älskade vyerna.

Fredrik Reshpja:

TESTAMENTI I SKENDERBEUT

Merreni shpatën time! Vëreni
mbi drurin më madhështor të bregdetit!

Le të vërtitet ajo nga duart e stuhisë.
E kam fjalën këtu: duhet
të armatosim çdo gjë.
Edhe erërat.

Ja edhe stapi im prej ulla. Mbilleni!
Mbi degët e tij mund të varni armët.
Duke vështruar kurmat plot plagë të ulla,ve,
gjithmonë kam menduar që ata janë drurët e luftës.

Ç`kisha ua dhashë.
Tani trupin tim ta zbrisni thellë nën tokë,
që kur të vijë vjeshta e fundit,
nga sytë e mi të mbijë gruri...

Fredrik Reshpja :

SKANDERBEGS TESTAMENTE *

Tag mitt svärd! Häng det
på kustens mest majestätiska träd!

Låt det svänga i stormens händer.
Jag säger eder: vi måste
till vapen förvandla allt.
Även vindarna.

Tag min stav av olivträ! Låt den slår rot!
Edra vapen kan ni hänga på dess grenar.
Jag har ofta skådat olivträdens sargade former
och alltid vetat att de är krigens träd.

Nu har jag givit allt.
Sänk nu min kropp djupt under jord,
så att vete gror från mina ögon
när sista hösten har kommit

* Georg Castrioti Skanderbeg, albansk medeltida furste
som satte stopp för turkiska imperiets framfart i Europa.

Skiro Di Maxho:

KANË PREHJE FJALËT

Drapëri i hënës ia mban fitilin natës
që të mos humben hijet
n'errësirë.

Kanë prehje fjalët
kanë pushim ligjëratat
e gjuhët s'kanë më shqiptime.

Prehje Arbëreshve
prehje fjalëve të tyre
prehje fjalëve të marra hua
nga fjalorët e lëtinjve
prehje fjalëve të zhdukura
te kjo ditë dhe përditë
nga fjalorët arbëreshë
edhe prehje e kësaj Hore.

Nga mëngjesi deri në mbrëmje
e merr fjalën që ta tregojë
dhembjen e njëmijë përrallave.

Fjala prehet
Mbi të është varur qetësia e detit.

Skiro Di Maxho:

ORDEN VILAR

Månskivan håller natten tänd
rädd att den skall förirra sig
i mörkret.

Orden vilar
föredragen rastar
tungomålen saknar uttal.

Albanezi vilar
deras ord vilar
lånade ord vilar
i latinarnas böcker
försvunna ord vilar *
idag och för alltid
i albanezis böcker
och vila i denna Hora.

Från morgon till kväll
lånar den ord för att uttala
smärtans tusen sagor.

Orden vilar
över dem hänger tystnadens hav.

* Försvunna ord - gammalalbanskan som håller på att försvinna i dagens Italien. Lagg märke till likheten mellan italiernalbaners situation och finlandssvenskars!

Vorea Ujko:

KOSOVA

Vëllezërve të Kosovës
nga zemër arbëreshe.

Ka hapa hijesh
të penguara në kapërcim
nga polipë të padukshëm
në labirinthe nekrolesh
ku unë sillem ndërmend
duke shkelur botë të vjetra.
Ndjej zëra të kumbueshëm
e trokëllimë kuajsh
që shuhën larg.
E gjithçka dendësohet
në trajta të papandehura
dhe shket n'ajr
një sens i pacaktuar
i çuditshëm i përmallshëm.
Këtu e nis unë udhëtimin
apo e mbaroj këtu
këtu unë të takova
këtu të ndjek
ende.

Vorea Ujko: *

KOSOVA

Till bröderna i Kosova
Från ett italo-albanskt hjärta

Skuggorna nalkas
osynliga tentakler
rammar alla hinder
i katakombernas irrvägar
där jag flackar runt
vandrande i svunna världar.
Jag hör klingande ljud
och hästarnas hovar
som tystnar i fjärran.
Och allting tättnar
till förbryllande former
en oklar närvaro
far genom luften
ofattbart längtansfull.
Här började min resa
och här slutar den
här möter jag dig
och här jagar jag dig
ännu.

* Vorea Ujko – italoalbansk diktare, ättling till de albanska släkter som flydde till Italien på 1500 -talet efter storfusten Georg Castriotis kamp mot turkarna.

Vorea Ujko:

VAZHDIM

Unë kam frikë se çdo gjë
do të jetë vetëm një lodër
e se kulla e dashurisë
një ditë do të rrëzohet
mbi avanturën time hiri.
Po sytë e tu të trishtuar
e çiltërsia jote e pastër
më thonë jo.

Vorea Ujko:

FORTSÄTTNING

Jag räds att allting
skall visa sig vara lek
att kärlekens torn
en dag skall falla
över mitt gråa äventyr.
Men dina sorgsna ögon
och din oskuldsfulla renhet
säger mig nej.

Natasha Lako:

TRENI DHE SHQIPTARËT

Treni dhe shqiptarët,
shqiptarët dhe biletat,
biletat dhe shfaqjet,
shfaqjet dhe përgëzimet,
përgëzimet dhe puthjet,
puthjet dhe harresat,
harresat dhe letrat,
letrat dhe të hollat,
të hollat dhe pullat,
pullat dhe dhuratat,
dhuratat dhe plehrat,
plehrat dhe gazetat,
gazetat dhe sandviçet,
sandviçet dhe lotët,
lotët dhe yjet,
yjet dhe këmbët,
këmbët dhe rrugët,
rrugët dhe biletat,
biletat dhe trenat,
trenat dhe shqiptarët.

Natasha Lako:

TÅG OCH ALBANER

Tåg och albaner,
albaner och biljetter,
biljetter och tillställningar,
tillställningar och välgångsönskningar,
välgångsönskningar och kyssar,
kyssar och glömska,
glömska och brev,
brev och pengar,
pengar och frimärken,
frimärken och gåvor,
gåvor och skräp,
skräp och tidningar,
tidningar och smörgåsar,
smörgåsar och tårar,
tårar och stjärnor,
stjärnor och fötter,
fötter och bakgator,
bakgator och biljetter,
biljetter och tåg,
tåg och albaner.

Natasho Lako:

HISTORIA

Një libër historie
mbi një raft të vjetër
vret një merimangë.
Fillon historia.

Natasho Lako:

HISTORIEN

En historiebok
i en gammal hylla
krossar en spindel.
Historien börjar.

Din Mehmeti:

NATË E TMERRSHME

E kam lëvar kokën mbi duar
tërësisht i tronditur

mendimet më shpiejnë
gjer në fund të ferrit

jashtë dëgjoj oshëtira përmbytëse
policia federale hedh gaz lotësjellës
e shtien me armë në yjet e qiellit tim

brenda llamba ime
më shikon me indiferencë
e mbi fjalët e mia pikon gjak
tak tak tak

Din Mehmeti:

FÖRSKRÄCKLIG NATT

Huvudet hänger i handflatorna
jag är omskakad

tankarna för mig
till helvetets nionde cirkel

utanför hör jag skriken svämma över
den federala polisen skjuter tårgas
och öppnar eld mot stjärnorna på min himmel

inuti
min glödlampa ser på mig helt resignerat
över mina ord droppar blodet
dropp dropp dropp

Din Mehmeti:

MOS U ZGJO

Ëndërr mos u zgjo
jeta është e lirë
për të ecur
në majë të gishtërinjve
 ëndërr mos u zgjo!

Din Mehmeti:

VAKNA INTE

Vakna ej min dröm
livet är fritt
att gå
på tåspetsar
min dröm vakna inte!

Agim Vinca:

I JASHTËZAKONSHËM

Jetoj në kushte të jashtëzakonshme
Furnizohem me artikuj jashtëzakonisht të shtrenjtë
Marr rrogë jashtëzakonisht të ultë
Thith ajr jashtëzakonisht të ndotur.

Jetoj në një vend të jashtëzakonshëm.
Rrethuar nga njerëz të jashtëzakonshëm
Jashtëzakonisht të qetë
Jashtëzakonisht nervozë.

Jetoj në gjendje të jashtëzakonshme.
Bëj gjumë të jashtëzakonshëm
Shoh ëndrra të jashtëzakonshme
(një ujk jashtëzakonisht të butë
e një qengj jashtëzakonisht gjakpirës!).

Sillem në mënyrë të jashtëzakonshme.
Jashtëzakonisht urtësisht
Jashtëzakonisht marrëzisht.

Vërtet jam i jashtëzakonshëm.
I jashtë - zakon - shëm!

Agim Vinca:

OVANLIG

Jag lever under ovanliga förhållanden
Jag livnär mig på ovanligt dyr mat
Jag får en ovanligt låg lön
Jag andas en ovanligt förorenad luft.

Jag lever i ett ovanligt land
Omgiven av ovanliga människor
Ovanligt lugna
Ovanligt neurotiska.

Jag lever under undantagstillstånd
Sover en ovanlig sömn
Ser ovanliga mardrömmar
(en ovanligt tam varg
och ett ovanligt blodtörstigt får!).

Jag betar mig ovanligt
Ovanligt klokt
Ovanligt dumt.

Jag är då sannerligen ovanlig
O - van - lig!

Agim Gjakova:

VJESHTA

Vjeshta erdhi në Tiranë
duke u mbajtur gisht për gishti me verën
mbrëmjen ma ktheu në ndjenjë të përtërirë
yjet zbritën nga larg e ranë
në valle
kujtimeve ua hapën derën
lehtë e lehtë, varg e varg
me dëshirë

Tërë natën i shikova shtëpitë e qytetit
e mendimet e mia u endën si drita
nëpër rrugë, nëpër çati, në hapësirë

Një thirrje më doli nga kraharori
në poezi u shtri
valë - valë

nga gëzimi syxixë më zu dita

Agim Gjakova:

HÖSTEN

Hösten kom till Tirana
hand i hand med sommaren
kvällen vändes till en känsla
och stjärnor från fjärran föll ned
i en ringdans
de öppnade minnenas tunga dörr
lätt och sakta, en efter en
längtansfullt

På natten betraktade jag stadens hus
tankarna lekte som ljuset
på gatorna, taken och rymden

Ett rop bröt sig ut ur bröstet
och lade sig som dikter
i våg efter våg

jag blev full av den glödande höstdagen

Azem Shkreli:

LINDJE

duhet thënë diç
për rimë
pa metrikë

duhet thënë diç
në mish të mendimit
si thikë

duhet thënë diç
si vdiset
pikë

Azem Shkreli:

BEGYNNELSE

något måste sägas
utan rim
utan meter

något måste sägas
tankens innersta
knivskarpt

något måste sägas
som döden
slutgiltigt

Ferdinand Laholli:

SAVRA *

këtu është frikë të flasësh
frikë të heshtësh

këtu është frikë të buzagazesh
frikë të zyrtosh

këtu është frikë të mos kesh frikë

* Savra, llogor pune.

Ferdinand Laholli:

SAVRA*

här är man rädd att prata
rädd att vara tyst

här är man rädd att le
rädd att vara dyster

här bör man vara rädd
för att inte vara rädd

*Savra - arbetsläger

Ferdinand Laholli:

KORÇËS

Të kam dashur fshehur,
të kam dashur heshtur,
si ai djali vajzën e ëndrrës së tij.

Ferdinand Laholli:

STADEN KORÇA

Jag älskade dig i hemlighet
med tystnadens lidelse
som pojkar älskar sina drömmars flickor.

Ismail Xhaferi:

VDEKJA E LASGUSH PORADECIT *

Lasgushi iku...
Shpirti qiellor mbi krahët e një mjellme
E di
do të vonojë
pranverë e sivjetme

* Lasgush Poradeci qe poet i cenzuruar.

Ismail Xhaferi:

LASGUSH PORADECIS DÖD *

Lasgush gick bort...
En himmelsk själ på en svans vingar
Jag vet
i år
kommer våren att dröja

* Lasgush Poradeci var en censurerad albansk diktare.

Rrahman Dedaj:

GËZUAR!

Nënës Terezë
Shpërblimi Nobël për paqe

Në institutet atomike edhe një herë
provohet ndarja e neutroneve.

Të pimë nën këtë ombrellë
në emër të humanizmit.

Rrahman Dedaj:

LÅTOM OSS SKÅLA

Moder Teresa tilldelas
Nobelpriset för fred

Runt om i världens kärnfysiska institutioner
utförs prov med klyvningen av neutroner.

Låtom oss skåla under våra gemensamma paraplyn
i humanismens namn.

Rahman Dedaj:

SHËNIME TË TË PUSHKATUARVE

Nga të dy anët e ëndrrës po afrohesh
Primabalerinë e hedhur
Apo fluturë e djegur

Dorë luledielli
O vashë që zgjohesh si liria

Po e trilloj hapësirën
Ose po tremben largësitë

Ma kërkon unazën
Ose ma hudhë mollën

Nëse jam në ëndërr
Gjithnjë e më pak më duhen fjalët
Dhe mos më trembni

Sytë më kanë mbetur në një ujëvarë
Duke shikuar fëmijën
Që i buzëqeshë ujit
Dhe trillon përralla naive
Në stilin e Ezopit

Derisa do të luaj era
Me flokët e mi prej barit

Rrahman Dedaj:

DE AVRÄTTADES ANTECKNINGAR

Från drömmens ytterkanter nalkas du
En vacker prima ballerina
Eller en bränd fjäril

En maskroshand
Eller en flicka som vaknar som friheten

Inbillar jag mig rymden
Eller är det horisonterna som skrämmer

Tillbaka begär Du min ring
Eller mitt adamsäpple

När jag drömmer
Behöver jag orden allt mindre
Skräm mig inte

Mina ögon vilar på ett vattenfall
Och ser ett barn
Som ler mot vattnet
Och skapar naiva sagor
I Aisopos' manér

Hur länge skall vinden leka
Med mina hårstrån av gräs

Jusuf Gërvalla *

NJË KËNGËTARI

Është diku një botë e largët dhe e dashur
është diku një melodi
është një sy i kaltër
një tejzë e këputur në kitarë

Është diku një akvarium
me peshq e algje t'arta që freskon
është një zemër diku si kuti
e në të një fjalë amshimi

Është diku diçka e vërtetë dhe një melodi

*Jusuf Gërvallën e vrau policia jugosllave
më 17. 02. 1982, në Gjermani.

Jusuf Gërvalla *

TILL EN SÅNGARE

Någonstans i fjärran finns en älskad värld
det finns en melodi
och blåa ögon
en avbruten sträng i en gitarr

Det finns någonstans ett akvarium
däri fiskar och gyllene alger
det finns ett hjärta någonstans som en ask
och i det evighetens ord

Det finns någonstans något verkligt och en melodi

* Jusuf Gërvalla dödades i ett attentat av jugoslaviska säkerhetsmän i Tyskland den 17 januari 1982.

Jusuf Gërvalla:

NGA MEMOARET E NJË SHETITËSI

Kur u ktheva nën pullazin tim
Mbuluar me kashtë
Nën qepallat e lodhjes e të kohës
Botën
E në botë s'kish tjetër pos
Shkëlqim ari e qelqi
Mbi rrashta e penda të larta zogj
Alumini
Kish edhe uri edhe poetë edhe
Ujëvarë në botë
Kish njerëz prej druri e kafshë të
Buta kudo
Kish edhe hieroglifë dy fjalë dhe
Gjurmë që s'fshihen
Kish lumenj të egër e fosile të lashta
Mes muresh të trasha fshesa
dhe minj.

Jusuf Gërvalla:

UR VANDRARES MEMOARER

När jag återvände under mitt tak
Täckt av hö
Sov jorden
Under trötthetens och tidens ögonfransar
Fanns det ingenting annat
Än guld – och silverskimmer
Långt ovanför kranier och höga dammar
Flög aluminiumfåglar
Det fanns även svält och diktare
Och vattenfall
I trä klädda människor och husdjur
Det fanns hieroglyfer ett par ord och
spår som inte sopats bort
Vilda floder och urgamla fossiler
Sopkvastar och råttor fanns kvar
Inom dessa tjocka väggar.

Fatos Arapi:

DHE AJO ERDHI

Ishte e gëzuar
vallëzonte
dhe e lumtur si një dritëz që ecën në errësirë
hyri në fatim tim tragjik
prej njeriu

Fatos Arapi:

HON KOM

Hon var glad
dansande och lycklig som en gnista
som rör sig i mörkret
trädde hon in i mitt tragiska
mänskliga öde

Xhevahir Spahiu:

NJERËZIMI *

Statuja e lirisë.

Liri e Statujës
në çastin hyjnor të krijimit.

Po kur,
kur do t'i ngjajë
simboleve të tij
Njerëzimi?

* Shkruar në Nju Jork, më 29.12.94

Xhevahir Spahiu:

MÄNSKLIGHETEN *

Frihetens staty.

Statyns frihet
i det gudomliga ögonblicket av dess skapelse.

Man undrar,
när Mänskligheten
kommer att bli lik
sina symboler?

* Skriven i New York, den 29.12.94

Hajdin Abazi:

BASTISJA *

E shqyen derën
pastaj kornizat në mure.

Edhe jastykët i shqyen
edhe rrobat e nxierra nga ormarët.

Kishin mbetur vazot.
Buzëqeshën.

I shkulen lulet prej tyre,
Dheun, si tallje, ia derdhën dyshemesë.

* Hajdin Abazi ka qenë i burgosur politik.

Hajdin Abazi:

DEN SERBISKA POLISENS HUSRANNSAKAN *

De bröt först upp ytterdörren
sedan alla ramar på väggarna.

De rev sönder våra kuddar,
likaså våra kläder nedplockade från garderoben.

Återstod vaserna.
Poliserna flinade.

Drog upp blommorna från krukorna.
Blomjorden hälldes föraktfullt ut på golvet.

* Hajdin Abazi var fängslad av serbiska
poliserna p.g.a. sina politiska åsikter.

Hajdin Abazi:

LEKSION NË ZYRËN E INSPEKTORIT

Rënja në skëterrë
nuk është
fundi i botës.

Fundi i botës
është
mbetja në të.

Hajdin Abazi:

LEKTION PÅ POLISENS KONTOR

Att ramla ner i helvetet
det är inte
världens slut.

Världens slut
är
att stanna kvar där.

Hajdin Abazi:

XHELATËT

Veshur me kostume
këmisha të bardha,
kollare.

Shtangem.

Thua se jam në ballo.

As syve s'ka mbetur
t'u besosh.

Hajdin Abazi:

BÖDLAR

Klädda i kostym
med vita skjortor
och slips.

Jag stod mållös.

Som om jag vore på bal.

Inte ens sina ögon
kan man lita på.

Kadrush Radogoshi:

SHOKËT E MI

U lindën
në pika të ndryshme të globit
Platoni i përzuri nga shteti ideal
i mallkoi...

Asnjë shtet nuk u dha azil
ata krijuan shtetin e tyre ...

Aty filluan ta krijojnë portretin e botës
me pika klorofili e polen lulesh
me krah dallëndyshesh e fluturime fluturash...

Në shtetin e tyre ideal
mbetën gjithmonë të rinj
dashnorë të përjetshëm mbetën
shokët e mi...

Kadrush Radogoshi:

MINA KAMRATER

De föddes
på olika platser på jorden
Platon förvisade dem från den ideala staten
och förbannade dem...

Ingen stat gav dem asyl
de skapade sin egen stat...

De började skapa bilden av världen
med prickar av klorofyll och pollen från blommor
med svalans vingar och fjärilars flykt...

I sin ideala stat
förblev de alltid unga
som odödliga älskare
mina kamrater...

Ismail Ymeri:

KULLËS

Kullë e ngritur
mbi gurë, hi, lotë.

Kullë e stërgjyshërve të mi
sërish e ringritur
mbi hi, lotë dhe gurë
me frengji
zotëra të horizontit
prej nga priteshin
mysafirët e paftuar
netëve të pabesa.

Ismail Ymeri:

STENTORN

Ett hus uppfört
över stenar, aska, tårar.

Mina förfäders boning
återuppförd
över aska tårar och stenar
med smala gluggar
där de såg mot horisonten
i väntan på
objudna gäster
under svekfulla nätter.

Ismail Ymeri:

ÇIFTELIA

Dru dhe çeliku
i përzier
vaj i popullit tim
netëve të pa gjumë

vaj dhe mjeshtri e rapsodit

për trimëri
dhe dështime
nëpër kohëra të liga.

Ismail Ymeri:

ÇIFTELIA*

Trä och stål
blandade med
mitt folks gråt
under sömnlösa nätter

folksångarens mästerliga klagosång

om bragder
och misslyckanden
genom onda tider.

* Çiftelia= tvåsträngat albanskt folkinstrument.

Ismail Ymeri:

MIKUT

Mik në të kaluarën,
pa të sotmen,
apo në të sotmen,
pa të kaluarën...

Ujqërit dhe qengjat
kanë ndërruar garderobën
mendojnë se
Don Kishotë të shumtë
jetojnë në këtë botë
apo e sotmja, Don Kishot
ka humbur rrugën
në oborr të vet.

Ismail Ymeri:

TILL EN VÄN

Vän i det förflutna
utan någon nutid
eller vän i nuet
utan ett förflutet...

Vargar och får
Har bytt garderober
ty, de tror att
mången Don Quijote
rider kvar i denna värld
eller så har nuet, Don Quijote,
kommit vilse
på sin egen bakgård.

Diamant Abrashi:

ALTERNATIVË E VETME

Dua të këndoj për gjëmën
që shekujve lamë
nëpër varrezat e të parëve
dua të flas për vajin
që ende shihet në buzët
dhe sytë tanë të përlotur.

Dua t'u them për ndrydhjen
që po më ndjek çdo hap
e vegimin e diellit
që ka zënë vend në bebzat tona.

Dua t'u tregojë për diellin
që ç'do agim të kuqërremtë shihet
për ditët me diellin që bartet horizontit
e buzëqeshjen e dëlirë të njerëzve
për pranverën që po lind.

Diamant Abrashi:

ENDA UTVÄGEN

Jag måste få sjunga sorgesången
som vi lät eka i sekler
på förfädernas kyrkogårdar
jag måste få tala om gråten
som ännu känns på vara läppar
och om våra tårfyllda blickar.

Jag vill berätta om den förlamande skuggan
som följer mina steg
och solskenets fägring
som stannat i våra ögon.

Jag vill berätta om solen
som färgar morgnarna i rött
om soliga dagar som skymtar bakom horisonten
och människors försynta leenden
över våren som kommer.

Alfred Lela:

ELEGJI PËR PAQEN

Shtetet këndojnë
elegji
për kufinj të vdekur.
Paqe
në ç'gardh telash me gjemba
ke mbetur?

Alfred Lela:

ELEGI FÖR FREDEN

Stater stämmer upp
sorgekväden
över utplånade gränser.
Fred
på vilket taggtrådshinder
blev du kvar?

Tahir Foniqi:

VARRIMI I MOZARTIT

Dhjetëra vetë e varrosnin Mozartin
tërë shekulli tetëmbëdhjetë në funeral
bisedohej për ikonat, zonjat, perandoritë
tek lindte Mozarti.

Tahir Foniqi:

MOZARTS BEGRAVNING

Inte fler än tio var de när de jordfäste Mozart
artonde seklet fanns med i följet
det konverserades om ikoner, fruar, imperier
när Mozart föddes.

Miradie Ramiqi:

BLLOKU VIZATIMOR I PARISIT

Të hetova në një pikturë në Luvër
I sfidoje portretit tënd të gjorë
Ç'bukuri ç'tmerr ç'tmerr ç'bukuri

Më shikoje nga piktura
Padiktueshëm ma vodhe qeshjen
Ndërsa në ballë hija ime të mrizonte

Dole nga ajo hije i tëri
Në shuplakën time u ule pastaj
Në një pikturë-tautazhë
Ç'bukuri ç'tmerr ç'tmerr ç'bukuri

Miradie Ramiqi:

ANTECKNINGSBLOCK I PARIS

Vid en målning i Louvren skymtade jag dig
Du utmanade till tvekamp ditt stackars porträtt
Det var vackert och hemskt och hemskt och vackert

Sen såg du mig från målningen
Obemärkt stal du mitt leende
Medan min skugga vilade mot din panna

Du kom ut hel från skuggan
Och satte dig på min handflata
Som en liten tatuerad målning
Vad vackert och hemskt och hemskt och vackert

Pal Ndrecaj:

31 DHJETOR

Ora 23
zvarritet edhe ora e fundit

Prapa po mbesin
gazetat dhe emisonet e televizionit
të lodhura duke llomotitur
për kriza, papunësi, inflacion.

Vitetve të ardhshme
thonë se këto
s'do ta emërojnë kohën tonë
së paku në gazeta.

Ora 23 e 30 minuta
akrepat po ndahen
edhe nga këto pak minuta të sëmurë.

Ora jonë së shpejti
do të shënojë kohë të re
Gëzuar!...

Pal Ndrecaj:

31 DECEMBER

Klockan är 23
sista timmen sniglar fram

Bakom ryggen kvarstår
tidningar och TV-sändningar
trötta av allt pratande
om kriser, arbetslöshet, inflation.

De kommande åren
sägs det
skall inte detta få känneteckna vår tid
om man får tro på tidningarna.

Klockan är 23 och 30
visarna stannar upp
även vid dessa få sjuka minuter.

Vår klocka skall snart
visa en ny tid
Skåll!....

Eqrem Basha:

NATË

janë shuar zjarret
as dritat e syve s'vetëtijnë

duket se fle

përsëri
përgjoj vetveten

Eqrem Basha:

NATT

eldarna har slocknat
inga ögon blixtrar heller

jag verkar sova

återigen
iakttar jag mig själv

Selman Jusufi:

PERGAMENTI

bie shi
pas njëmijë e një bjeshke
në një rrafshinë të butë të tokës hamullore
shi, shi shi...
ka tri net
tri ditë
dhe njëqind vjet vetmi
që bie shi, shi shi...
shi bie në tavolinën time të shkrimit

m'u kalbën të lashtat e kujtimeve
dhe ashti i dorës së djathtë
s'dal në rrugë se bie shi
rri e shkruaj dhembjen time
e dora më mpihet.

Selman Jusufi:

PAPIRUS

det regnar
bakom tusen och ett berg
på en mjuk platå i ett förlovat land
regn, regn, regn...
i tre nätter nu
i tre dagar
och hundra år av ensamhet
då det regnar, det regnar, det regnar...
det regnar på mitt skrivbord

minnenas skörd ruttnar
likaså benen i höger hand
jag kommer inte ut för att det regnar
jag stannar inne och skriver ut min smärta
medan handen domnar.

Sabile Basha:

KOHA

Dje kohës
i vodhëm kapelën
kokën tullace ia pamë
i përqeshëm shkëlqimin
dhe me vek kohor
i bëmë kësulë të re
për stinët e bardha.

Sabile Basha:

TIDEN

I går blev tiden
bestulen på sin mössa
vi såg dess kala hjässa
och skrattade åt dess sken
sen med tidens väv
vävde vi en ny mössa
för kommande årstider.

Sabri Hamiti:

FUNDI I DETIT

piratët gërryejnë fundin e detit
brigjet i kanë marrë ethet
ti që pi duhan në vetmi
edhe sa vite zgjat nata
a e di

priatët gërryejnë fundin e detit
brigjet po i marrin ethet
e nuk ka asnjë valë të valë
ti që pi duhan në vetmi
a e di

Moikom Zeqo:

TEMPULLI I VJESHTËS

Te tempulli i vjeshtës nuk vijnë hyjnitë
po romët afrohen me kurora lulesh
arinjtë kërcejnë nën tingujt e dajreve
me putrat me çizme përralle

Te tempulli i vjeshtës gurëzohen zërat
bronzohen lulet e flakëta
arinjtë me çizme nxjerrin zjarre nga goja
e i sjellin pranverat e ndrojtura

Te tempulli i vjeshtës romët ringjallen
me bestytnitë e magjisë së tyre
eshtrat u thërmohen si ar
për maskat e karnavaleve të famshëm

Te tempulli i vjeshtës dashuria është pritje
dhe retë shtatzëna pjellin ylbere
romët e gjejnë qendrën e botës
e polin e tretë të ekzistencës

Moikom Zeqo:

HÖSTENS TEMPEL

Till höstens tempel kommer inga gudar
blott zigenare nalkas med blomsterkransar
och björnar som dansar till gatumusik
med tassar i sagornas stövlar

Vid höstens tempel förstenas alla röster
glödande blommor förvandlas till brons
björnar i stövlar spyr eld ur gapet
och drar med sig förskrämda vårar

Vid höstens tempel pånyttföds zigenarna
med sina vidskepelser och magier
deras ben krossas som guld
till masker för lysande karnevaler

Vid höstens tempel där kärlek är blott väntan
och havande moln föder regnbågar
där hittar zigenare världens mittpunkt
och en tredje sagolik pol för tillvaron

Moikom Zeqo:

SAGË DASHURIE

U therrën me thika të mprehta dy djem
të dashuruar në të njëjtën vajzë,
gjaku rrodhi mbi pergamentet e gjetheve
të vjeshtës së vdekur në strall.

Thika hapën plagë në trupat e bukur
kokëprerë me tmerr vdiq një djalë
tjetri plagosur, fitimtar i lemerishëm,
bëri dashuri me vajzën mbi bar.

U puthën me ankh, me epsh të paparë
pa menduar më për të vdekurin në shi
shpejtonin ta rilindin atë te një fëmijë
nga thika e verbër të vdiste përsëri.

Moikom Zeqo:

KÄRLEKSSAGA

Med kniv i hand gjorde de upp
förälskade i samma brud,
och blodet rann på lövens hud
och hösten drog på sig dödens skrud.

I vackra kroppar skar skarpt kniven
med öppen strupe dog en i sitt blod
den andra sårad, som vinst i skräck,
med flickan i gräset fick tillbaka sitt mod.

De kysstes hårt, med våldsamt lust,
tänkte ej på den döde bredvid
de hade brått att jämna förlust
att ge liv till att spillas i mord på nytt.

Vehbi Skënderi:

MBAJ NJË ZEMËR GRUAJE NDËR DUAR

Mbaj një zemër gruaje ndër duar. Mollë të
ëmbël!
Shoh përherë ëndërr. Shoh syçelur ëndërr
rrugëve...

Druaj mos shpejtoj hapin e troshitet,
mos më zë ferra shtegun e gërvishtet,
mos më shkel këmba në akull dhe më vritet!

Druaj mos vrejtet qielli e trishtohet,
mos zemrohet deti e pikëllohet,
mos bie kund tërmeti dhe lëndohet!

Kam ndër duar një zemër gruaje. Shihni! se
ç'mollë e ëmbël.
Shikoj syçelur ëndërr rrugëve. Shoh tek çapitem
në ëndërr...

Kam frikë mos ma gjuan kush me gur.
Kam frikë!
Mos ma ngrin vrik acari, bari mos ma fshikë.
Mos ma djeg shkrumb zjarri...
Mos ma vret kush me fjalën-plumb. Kam frikë!
Kam frikë!

Mbaj një zemër gruaje ndër duar! (Kurrë
s'kam mbajtur thesar më të çmuar!)

Druhem mos ma thajë bryma. Mos ma helmojë
ndryshku e tymi i ambientit.
Shkel mbi qelqe e thëngjij të papushuar
sikur mbaj në gji kristalet e inxhinjtë e Orientit!

Mbaj një zemër gruaje ndër duar!
Mbaj një zemër gruaje ndër duar!

Vehbi Skënderi:

EN KVINNAS HJÄRTA I MIN HAND

Jag håller en kvinnas hjärta i min hand. Ett så sött äpple!

Jag drömmer för jämnan. Med vidöppna ögon ser jag drömmar på gatorna.

Jag räds för att rusa i hast och krossa det,
att snubbla på taggiga buskar och riva det,
och halka på isar och förstöra det!

Jag räds att himlen mulnar och skrämmer det,
att havet rasar och gör det ledset,
att jorden skakar någonstans och skadar det!

Jag håller en kvinnas hjärta i handen. Se! ett så sött äpple.

Med vidöppna ögon drömmer jag. Jag ser hur jag stapplar i sömnen...

Jag räds att nån ska kasta stenar på det.
Jag räds!
Jag räds att kölden ska frysa det, att gräset
ska dölja det.
Jag räds!
Att elden ska bränna det till grus och aska.
Att onskans ord ska dräpa det. Jag räds!
Jag räds!

I handen håller jag en kvinnas hjärta! (Jag
har aldrig haft en mer dyrbar skatt!)

Jag räds att frosten ska torka det! Att rost och
dimmor ska förgifta det.
På glasskärvor går jag och på brinnande kol:
som om höll jag i handen kristaller
och ädelstenar från Orienten!

Jag håller en kvinnas hjärta i händerna!
Jag håller en kvinnas hjärta i händerna!

Shefki Oseku:

NJË LLOJ DRITE TJETËR

Edhe njëherë i lexova poezitë e mia për ty
befas më ra në sy se:
për së tepërmi i përmendkam yjet, diellin, hënën ylberin
(mbase jam frikësuar
mos, vallë, brenda vargjeve të mia po të kaplon një hije terri!?).
Sonte, në këtë poezi, s'do t'i përmendi këto
do ta gjejë një lloj drite tjetër, të panjohur deri më tani,
që të llamburisë mbi këto udhë të gjata të rreshtave.
Gurë s'do të lë pa lëvizur - këtë dritë për ta gjetur!
Por, vallë, si do ta gjejë unë, poeti?
Po, më duket se rrugëdalje tjetër s'më ka mbetur
veçse n'e marrsha emrin tënd
Doruntinë!

Shefki Oseku:

ETT ANNAT SORTS LJUS

Ännu en gång läste jag mina dikter om dig
plötsligt insåg jag:
jag nämner ofta stjärnor, solen, månen, regnbågen
(som vore jag rädd
att du täcks av min dikts mörka skuggor!?).
Den skall du inte hitta i denna dikt
jag skall finna ett annat sorts ljus, hittills okänt,
som ska kasta sitt sken över radernas långa väg.
Världens alla stenar skall vändas uppochner - för att finna det!
Men, var och hur ska hitta det jag, poeten?
Jo, det verkar som om det inte finns något annat sätt
än att till ljus döpa om ditt namn
Doruntina!

Shefki Oseku:

ASGJË PREJ QIELLIT

dy duar të ngritura lartë
nuk e përshëndesin diellin
që e ka varë qafën në perëndim
as hënën që po përgatitet ta marrë fronin qiellor

ato asgjë nuk kërkojnë prej qiellit

dy duar të ngritura lartë thonë diç
që me gojë kurrësi s'mund të thuhet

pikëtor o pikëtor!
ti kurrë s'ke për ta ditur
se ç'bojë ka pikëllimi njerëzor.

Shefki Oseku:

INGET SVAR FRÅN HIMLEN

två uppåtsträckta armar
är ej någon hälsning åt solen
som hänger i väster
eller ens månen som gör sig beredd att inta himlavalvets tron

de söker ingenting från himlen.

två uppåtsträckta säger något
som aldrig kan sägas i ord

målare, o målare!
du kommer aldrig att kunna fånga
den sanna färgen på människans sorg.

Shefki Oseku:

DASHURI POETI

të thoja kur u ndamë:
kurrë mos e dashuro poetin
veshet pa shije,
mantilin vjeshtor në dimër
vallëzimet e reja s'i di...
ai di veç të dashurojë deri në vdekje
dhe, asgjë tjetër.

Shefki Oseku:

DIKTARENS KÄRLEK

jag varnade dig då vi skildes:
bli aldrig kär i en poet
han klär sig alltid slarvigt,
har höstkläder på vintern
han kan inga nya danser...
han kan bara älska till döds
och ingenting annat.

Shefki Oseku:

BALADË PËR POETIN

e kërkujnë n'tokë e n'qiell
varr s'lënë pa shpluar
por s'e gjejnë dot
mbi plep të lartë të një balade
një zog prore e vajton.

Shefki Oseku:

BALLAD FÖR DIKTAREN

de söker honom mellan himmel och jord
gamla gravar grävs upp
men honom hittar de inte
uppe i en ballads höga poppel
sjunger en fågel klagosång om hans död.

Rizah Sheqiri:

ARTI I DURIMIT

Si artist i madh në këtë kohë të ligë
Ushtroj artin më të rëndë - durimin

Rizah Sheqiri:

TÅLAMODETS KONST

Som en stor skådespelare i den här onda tiden
Övar jag mig på den svåraste konsten - tålamodet.

Rizah Sheqiri:

BUZËQESHJE E RREME

Dikush dheun nën këmbë ma paska pas gërryer
Duke më buzëqeshur më paska pas urryer.

Rizah Sheqiri:

DET FALSKA LEENDET

Någon hade grävt upp marken där jag stod
Och hela tiden hatat mig medan han log.

Elsa Stavro:

PRITJE

Në pritje nuk jam unë
po dikush që trembet
mos ti harron e s'vjen.

Elsa Stavro:

VÄNTAN

Det är inte jag som väntar
utan en som räds
att du glömmer att komma.

Feride Papeka:

HELA MITT JAG VÄNTAR

hela mitt jag väntar
jag förenar en sol som gror ovanför mitt huvud
och tar en gudoms outplånliga form
jag skönjer långa resor
på bottnar av försvunna floder
som man minns med nostalgi
likt kärlekar som förlorats
över berg som täckts av hav
och utstöter mystisk klagan under vatten
över trädens silverkransar
som minns odödliga döda
på förglömda vägar
som drömmer om återuppståndelse
från urgamla kartor
väntar jag...

Ndoc Papeka:

ÇDO NATË

çdo natë
në ëndërr kthehem te vendlindja
pranë vatrës së largët

tashti të gjitha ëndërrat e mia
kanë formën e udhëve
që më presin

të gjitha mëngjeset
shndërrohen në rrugë
që më presin

rrugë e kthimit
mëngjesi më i madh
me diellin që agon te vatra

Ndoc Papeka:

VARENDA NATT

varje natt
återvänder jag i drömmen till min hemort
och sitter vid fjärran härd

alla mina drömmar numer
liknar vägar
som väntar mig

alla morgnar
förvandlas till vägar
som tåligt väntar mina steg

vägarna tillbaka
ni har den ljusaste morgonen
med en sol som går upp där hemma

Ariola Vishnja:

DIMËR E HESHTJE

si humbe kaq papritur
në re malli
sikur u trete pas një buzëqeshje
e unë mbeta këtu
me vetminë time
e pazonja të dal nga ky dimër
heshtje

Ariola Vishnja:

VINTER OCH TYSTNAD

du försvann så fort
i moln av längtan
du upplöstes i ett leende
och jag blev kvar
i min ensamhets boning
oförmögen att hitta ut ur vintern
ur tystnaden

Ndoc Gjetja:

SONTE

Shikoj fytyrën e fëmijës në gjumë
Dhe me vete them
Ky do të jetë unë
Në kohën kur unë s'do të jem

Dhe nuk ngopem duke e këqyrë
Vazhdimin tim të mirë.

Ndoc Gjetja:

I KVÄLL

Jag ser barnets ansikte i sömnen
Och säger till mig själv
Han ska vara jag
I tider då jag inte längre finns

Och jag blir inte mätt på att beskåda
Min goda fortsättning.

Tatjana Kurtiqi:

SHITËSI I BANANEVE

Pranë teje kaloj kokulur
i trembem tundimit
çmimi i bananes sa gjysma e bukës.
Rigojnë pika shiu.
"Ç'më solle?" thonë sytë e tim biri
e hapat i tkurr me keqardhje.
Për të
e për bukën e tuve
e blej një banane.

Tatjana Kurtiqi:

BANANFÖRSÄLJARE

Jag går förbi dig med nedböjt huvud
rädd för frestelsen
en banan kostar lika mycket som ett halvt bröd.
Det faller duggregn.
"Vad har du åt mig" frågar min sons ögon
sorgsen saktar jag mina steg.
För honom
och för dina barns levebröd
köper jag en banan.

Elida Buçpapaj:

VALËT

valët ndjekin linkth njëra - tjetrën
pastaj të gjitha bashkë mua
më ndjekin
më zënë
dhe pastaj pa dashur unë aspak
më lënë

valët ndjekin likth njëra - tjetrën
pastaj të gjitha bashkë mua

Elida Buçpapaj:

VÅGOR

vågorna jagar ikapp varann
och vänder sig sen tillsammans mot mig
jagar mig
fångar mig
utan att jag vill det
lämnar de mig

vågorna jagar ikapp varann
och vänder sig sen tillsammans mot mig

Shqiptar Oseku:

ARRATIA

thonë se unë s'e paskam zgjedhur
por ajo më paskësh zgjedhur mua
protestoj:
ne kishim një relacion të fortë
ekzistonte një mundësi për të zgjedhur
mes Jetës e Vdekjes
dhe unë vendosa vet

më lëndon nëse e harron këtë

Shqiptar Oseku:

FLYKTEN

de säger att jag inte valde den
utan att den valde mig
jag protesterar:
vi hade nog ett ömsesidigt förhållande
det fanns någonstans ett val
mellan Liv och Död
och jag tog det

du sårar mig om du glömmer det

Shqiptar Oseku:

VËREJTJE

në ëndërr gjithçka është e mundur
ke mendjen
jeta shpesh është ëndërr e ligë

Shqiptar Oseku:

V A R N I N G

i en dröm är allting möjligt
se upp
livet är ofta en ond dröm

Përmbajtja – Innehållet :

Ett par ord om de översatta dikterna

Dy fjalë për poezitë e përkthyer

Ismail Kadare

Ali Podrimja

Martin Camaj

Frederik Reshpja

Spiro Di Maxho

Vorea Ujko

Natasha Lako

Din Mehmeti

Agim Vinca

Agim Gjakova

Azem Shkreli

Ferdinand Laholli

Ismail Xhaferi

Rrahman Dedaj

Jusuf Gërvalla

Fatos Arapi

Xhevahir Spahiu

Hajdin Abazi

Kadrush Radogoshi

Ismail Ymeri

Diamant Abrashi

Alfred Lela

Tahir Foniqi

Miradie Ramiqi

Pal Ndrecaj

Eqrem Basha

Selman Jusufi

Sabile Basha

Sabri Hamiti

Moikom Zeqo

Vehbi Skënderi

Shefki Oseku

Rizah Sheqiri

Elsa Stavro

Feride Papeleka

Ndoc Papeleka

Ariola Vishnja

Ndoc Gjetja

Tatjana Kurtiqi

Elida Buçpapaj

Shqiptar Oseku

SVENSK POESI PÅ ALBANSKA - POEZIA SUEDEZE NË SHQIP
(POEZIA SHQIPE NË SUEDISHT - ALBANSK POESI PÅ SVENSKA)

I URVAL OCH ÖVERSÄTTNING AV
ZGJODHI DHE PËRKTHEU

SHQIPTAR OSEKU

KONTROLL OCH KORREKTURLÄSNING
för dikterna på svenska språket:

Ullmar Qvick
Marianne Bengtsson

Korrektorë-lektorë
për poezitë në gjuhën shqipe

Shefki Oseku
dhe
Ulmar Kvik

Dataansvarig:
Kompjuterizimi:

Frashër Oseku

Sjunde förbättrade upplagan

Botimi i shtatë, i përmirësuar

Tryckning i februari 2002

U dorëzua në shtyp në shkurt të vitit 2002

UTGIVEN AV TIDSKRIFTEN "DRITA" I TRELLEBORG – SVERIGE

BOTIM I REVISTËS "DRITA" NË TRELEBORG - SUEDI